



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Diasporës / Ministarstvo za Diasporu / Ministry of Diaspora

Strategjia

Për Diasporën dhe Mërgatën

2013-2018

Prishtinë, korrik 2013

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1.1	Rreth Strategjisë.....	5
1.2	Historiku i diasporës së Kosovës	6
1.3	Roli i diasporës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës	7
1.4	Kosova për diasporën.....	8
II.	ARSYET E HARTIMIT TË STRATEGJISË PËR DIASPORËN DHE MËRGATËN.....	9
III.	HYRJE.....	10
IV.	BAZA JURIDIKE DHE LIGJORE.....	11
V.	PARIMET E PËRGJITHSHME.....	12
VI.	METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË.....	13
VII.	VIZIONI I STRATEGJISË.....	14
VIII.	MISIONI I STRATEGJISË.....	14
IX.	ANALIZA E SITUATËS	15
9.1	Etapat dhe arsytet e emigrimit.....	15
9.2	Përfaqësimi politik dhe pjesëmarrja në vendimmarrje	16
9.3	Ruajtja e identitetit kulturor dhe e gjuhës.....	17
9.4	Integrimi në vendet pritëse.....	18
9.5	Potenciali dhe perspektiva e diasporës në zhvillimin ekonomik	18
X.	OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË STRATEGJISË.....	20
XI.	PROMOVIMI DHE AVANCIMI I TË DREJTAVE POLITIKE DHE SOCIALE TË DIASPORËS	20
11.1	Krijimi i kornizës insitucionale për përfaqësim politik të diasporës dhe pjesëmarrje në vendimmarrje dhe politikbërje	20
11.2	Krijimi i regjistrit të diasporës	21
11.3	Përmirësimi i shërbimeve ndaj diasporës nëpërmjet fuqizimit të zyrave/zyrtarëve për ndërlidhje me diasporën.....	22
11.4	Lehtësimi i kthimit të pensionistëve dhe të tjerë	22
XII.	RUAJTJA E IDENTITETIT DHE FUQIZIMI I LIDHJEVE ME DIASPORËN	23
12.1	Ruajtja e gjuhës amtare nëpërmjet programeve edukative-arsimore dhe kulturore për diasporën	23
12.2	Diplomacia publike / promovimi i identitetit shtetëror.....	24
12.3	Avancimi i rolit të medieve në fuqizimin e lidhjeve me diasporën.....	24
12.4	Lehtësi për të rinjtë e diasporës që të studiojnë në universitetet e Kosovës.....	25

12.5	Diaspora dhe shkenca	25
XIII.	INTEGRIMI I PJESËTARËVE TË DIASPORËS NË SHTETET KU JETOJNË	26
13.1	Ndihmë për organizimin e diasporës, me qëllim të lehtësimit të integrimit.....	26
13.2	Promovimi i të drejtave dhe i obligimeve të pjesëtarëve të diasporës	26
13.3	Bashkëpunimi i diasporës me autoritetet përkatëse (në nivel qendror, rajonal e lokal) ...	27
XIV.	PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK	28
14.1	Fuqizimi i bashkëpunimit me diasporën për zhvillimin ekonomik të Kosovës	28
14.2	Promovimi dhe tërheqja e investimeve nga diaspora	28
14.3	Lehtësimi i investimeve për diasporën	29
14.4	Nxitja dhe promovimi i kthimit të potencialit intelektual	30
XV.	MONITORIMI DHE ZBATIMI	31
XVI.	PËRFUNDIMI	33

[**Aneks. Plani i Veprimit**](#)

LISTA E SHKURTESAVE

MeD	Ministria e Diasporës
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MTI	Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MF	Ministria e Financave
MKRS	Ministria e Rinisë, e Kulturës dhe e Sportit
UP	Universiteti i Prishtinës
APIK	Agjencia e Promovimit të Investimeve në Kosovë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit
D4D	Demokracia për Zhvillim
DfD	Diaspora për Zhvillim
QKKDM	Qendrat Kulturore të Kosovës për Diasporë dhe Mërgatë
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
ARC	Agjencia për Regjistrimin Civil
OJQ	Organizatrat joqeveritare
AKB	Aleanca Kosovare e Biznesit
OEAK	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Rreth Strategjisë

Dokumenti i politikave “Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018” reflekton zotimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përkushtimin e saj për forcimin e kujdesit dhe të frymës bashkëpunuese me pjesën e popullit që fizikisht gjendet jashtë territorit të saj.

Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën është dokumenti i parë strategjik i Qeverisë së Kosovës, nëpërmjet së cilës, me veprime konkrete, synohet të sigurohen avancimi i të drejtave politike e sociale të diasporës, ruajtja e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës, shmangia e asimilimit, ndihma për integrimin në vendet ku jetojnë dhe lehtësi maksimale ligjore e administrative për ata që duan ta ndihmojnë zhvillimin ekonomik të atdheut të tyre.

Strategjia, po ashtu, synon organizimin sa më të mirë të diasporës së Kosovës, duke ndihmuar forcimin e rrjetëzimit të organizatave, shoqatave ose federatave të diasporës kosovare nëpër botë me idenë e fuqizimit të rolit të saj.

Nëpërmjet Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Diasporën dhe Mërgatën, synohet të kulmojë bashkëpunimi ndërmjet diasporës dhe Qeverisë, përkatësisht ndërmjet të gjitha ministrive, komunave dhe institucioneve të tjera, aktivitetet e të cilave janë paraparë të lidhen me diasporën, në këtë dokument.

Ky dokument politikash ndahet në dy pjesë: Strategjia për Diasporën e Mërgatën dhe Plani i veprimit. Ky i fundit përmban një gamë të gjerë masash dhe aktivitetesh që parashikohen të zhvillohen nëpër vite, në periudhën pesëvjeçare.

Sektorët që janë të përfshirë në këto dy dokumente dhe që do të përcaktohen më poshtë si objektiva strategjike kanë të bëjnë me përfshirjen e domosdoshme të masave që Qeveria e Republikës së Kosovës do t’i marrë në kuptimin ligjor, politik strategjik për diasporën.

Objektivat specifike, aktivitetet, përgjegjësitë, vlerat buxhetore të Strategjisë janë të specifikuara në mënyrë të hollësishme në matricën e Planit të Veprimit, në të cilin ndërlidhen aktivitetet konkrete me rezultatet e matshme dhe identifikohen institucionet përgjegjëse për financimin e tyre.

Për të pasur një lidhje shumë më të fuqishme shpirtërore e institucionale mes Kosovës dhe diasporës, Republika e Kosovës e harton këtë dokument politikash, me anë të të cilit për një periudhë pesëvjeçare (2013-2018) synohet të arrihet realizimi i këtyre objektivave të përgjithshme të Strategjisë:

- Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
- Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën;

- Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë; dhe
- Lehtësimi i përfshirjes së diasporës në zhvillimin socio-ekonomik.

Këto objektiva, në masë të madhe, janë pjesë e pandashme e zhvillimit të politikave që ka ndjekur Qeveria e Kosovës, veçanërisht Ministria e Diasporës, për të siguruar avancimin e pozitës së diasporës në vendimmarrje, ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditës së vendit të origjinës, si dhe krijimin e kushteve dhe mundësive më të mira për një treg të favorshëm për hapjen e bizneseve të reja nga diaspora në Kosovë.

Për më tej, këto objektiva të strategjisë përcaktojnë mbajtësit e punëve dhe të aktiviteteve, të cilët në periudhën pesëvjeçare duhet t'i krijojnë kushtet e nevojshme për promovimin sistematik të vlerave të këtij komuniteti dhe ta përkrahin atë për t'i gjetur format më të mira të organizimit e të komunikimit me vendin e origjinës dhe me vendet ku jetojnë, të iniciojë potencialin e saj krijues në projekte me interes të përbashkët. Themelimi i Komisionit të veçantë parlamentar për diasporën do ta plotësonte artikullimin e nevojave të diasporës, sa i përket adresimit të çështjeve për diasporën.

Secili nga katër objektivat e përgjithshme përmban edhe objektivat strategjike, të cilat do të jenë të përshkruara te pjesa "Objektivat e përgjithshme të Strategjisë".

1.2 Historiku i diasporës së Kosovës

Diaspora kosovare është një potencial me një vlerë shumë të madhe. Edhe pse gjendet jashtë territorit të atdheut të saj, ajo është pjesë e pandarë e kulturës shpirtërore dhe materiale të historisë së popullit të Republikës së Kosovës.

Përkufizimi i pjesëtarit të diasporës paraqet një sfidë teorike, duke marrë parasysh vështirësitë në përcaktimin e këtij komuniteti.

Por, me Ligjin nr. 04/L 095 të Diasporës dhe Mërgatës është bërë një përpjekje për definimin e këtij nocioni, duke paraqitur një përkufizim mjaft të përgjithshëm, në të cilin pjesëtar i diasporës dhe i mërgatës konsiderohet *çdo person që ka vendbanim ose vendqëndrim jashtë Republikës së Kosovës dhe që ka lindur ose ka prejardhje familjare nga Kosova.*

Nisur nga proporcioni me popullatën e vendit të origjinës, Kosova konsiderohet njëri nga vendet me një diasporë shumë të madhe. Emigrimi jashtë atdheut ka ndodhur nëpër faza të ndryshme. Fillet e emigrimit të diasporës kosovare besohet të jenë që nga pjesa e parë e shekullit të kaluar, kur në mënyrë masive qindra-mijëra familje iu nënshtruan një fushate të egër spastrimi dhe përndjekjeje nga pushteti i Serbisë. Pjesa më e madhe e saj janë vendosur në Turqi. Në ditët e sotme, komuniteti shqiptar në këtë shtet besohet të jetë shumë i madh (ende mungojnë statistikat e sakta). Një pjesë shumë e madhe e tij sot e asaj

dite i ruan gjuhën dhe zakonet e veta, ndërsa pjesa tjetër është integruar plotësisht në shoqërinë turke.

Që nga ajo kohë, emigrimi ka qenë karakteristikë e vazhdueshme e shoqërisë kosovare. Me përjashtim të periudhës së pasluftës në Kosovë, tendencat për emigrim, në radhë të parë, kanë qenë të nxitura nga përndjekja prej sistemit ish-jugosllav për shkaqe politike, pastaj arsye ekonomike, etj. Në këtë pikëpamje, çështja e ruajtjes së gjuhës dhe e identitetit, si dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën mbetet një synim i rëndësishëm i Republikës së Kosovës, në mënyrë që të shmanget asimilimi i këtij komuniteti dhe të rrezikohet humbja e kësaj pjese të shoqërisë sonë.

Diaspora kosovare, në përgjithësi, është e shpërndarë anembanë botës, por, megjithatë, gjithmonë ka qenë dhe ka mbetur lidhja më e mirë e më kuptimplote e Kosovës me vendet ku ajo vepron e jeton. Përpos shpërndarjes kryesisht në shtetet perëndimore, diasporën kosovare e karakterizon edhe integrimi i saj në shtetet ku jeton e vepron, si dhe i brezave të rinj që janë lindur dhe rritur larg vendlindjes. Shpërndarja, veprimi disadekadësh i kësaj mërgate janë elemente përcaktuese që shprehin potencialin e saj, që ka pasur dhe ka peshë të veçantë për Kosovën.

1.3 Roli i diasporës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës

Diaspora kosovare me dekada ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm dhe e ka mbajtur gjallë jetën politike, sociale e kulturore në Kosovë. Ajo ka qenë arteria kryesore që e ka mbajtur jetën gjallë në Kosovë, në vitet më kritike për vendin dhe fatin e saj, në fundshekullin e kaluar. Një rol veçanërisht të rëndësishëm diaspora ka luajtur në vitet '90-'99, kur e ka financuar sistemin e pavarur arsimor e shëndetësor, si dhe sfera të tjera të jetës në Kosovë.

Gjithashtu, një rol tjetër, jashtëzakonisht të rëndësishëm, diaspora ka luajtur edhe në sensibilizimin e çështjes së shqiptarëve të Kosovës për dhunën dhe represionin që ushtrohej ndaj tyre nga regjimi i Milosheviqit. Po ashtu, diaspora konsiderohet promotori dhe mbështetësi kryesor dhe i gjithanshëm i luftës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Pas mbarimit të luftës, në vitin 1999, dhe vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, UNMIK-ut, roli i diasporës kosovare filloi të zbehej dhe gradualisht, me zhvillimet në vend, u krijua një hendek mes Kosovës dhe diasporës, duke i dobësuar raportet e tyre. Pas mbarimit të luftës, shumë organizata dhe asociacione jopolitike ose politike që vepronin në diasporë u pasivizuan dukshëm dhe një pjesë e aktivistëve që kishin vepruar atje, u kthyen në Kosovë, duke u angazhuar në jetën politike dhe ekonomike të vendit.

1.4 Kosova për diasporën

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008, dhe kalimit nga institucionet e përkohshme në ato shtetërore, me përgjegjësi të plota juridike dhe politike, Republika e Kosovës filloi të bënte hapa seriozë drejt lidhjeve më të fuqishme me diasporën, në kuptimin institucional.

Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2011 e themeloi Ministrinë e Diasporës, si trashëgimtare e Agjencisë së Mërgatës, e cila vepronte brenda Zyrës së Kryeministrit. Ministria e Diasporës ka mision forcimin e frymës bashkëpunuese në vijën institucionale mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe diasporës. Për më tej, ajo synon të promovojë, të ruajë dhe të kultivojë identitet kulturor, gjuhësor dhe arsimor të mërgimtarëve, duke hartuar legjislacion përkatës ose nëpërmjet programeve të ndryshme.

Kjo ministri ka hartuar një varg politikash për përfshirjen e diasporës në jetën politike e sociale në vend, si dhe për promovimin dhe ruajtjen e gjuhës, traditës dhe kulturës, siç është procesi i përgatitjes së bazës ligjore dhe institucionale, bashkë me Republikën e Shqipërisë, për hartimin e kurrikulës unike për mësimin e gjuhës dhe të kulturës kombëtare në shkollat e mësimin plotësues në diasporë. Po ashtu, ka filluar hapja e qendrave kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën. Qendra e parë është hapur në Republikën e Turqisë, ndërsa është në proces edhe hapja e qendrave të tjera në vendet ku janë me interes për diasporën dhe mërgatën, si dhe për shtetin e Kosovës.

Krahas iniciativave në nivelin qendror, ka përpjekje edhe në nivelin lokal për fuqizimin e lidhjeve me diasporën dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për të. Pothuajse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës kanë themeluar zyra të veçanta për diasporën ose kanë emëruar zyrtarë.

II. ARSYET E HARTIMIT TË STRATEGJISË PËR DIASPORËN DHE MËRGATËN

Duke marrë parasysh kontributin e madh të diasporës për lirinë dhe pavarësinë e vendit, kontributin në aspektin e remitencave, Kosova tashmë vlerëson se ajo ka nevojë për përkrahje në ruajtjen e identitetit, kulturës dhe të gjuhës në vendet mikpritëse, por, në anën tjetër, diaspora mund të ofrojë kontribut edhe në forma të tjera, që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit.

Këto përfshijnë investime të drejtpërdrejta në biznes, kontribute filantropike (humanitare), zhvillimin e tregut ndërkombëtar dhe lidhjeve të biznesit, si dhe transferimin e njohurive dhe përvojave të fituara jashtë vendit.

Meqenëse Kosova vazhdon të jetë shteti më i ri në Evropë, diaspora e saj luan një rol shumë të rëndësishëm në reflektimin pozitiv të shoqërisë kosovare te shoqëritë perëndimore. Së këndejmi, diaspora mund të luajë një rol jashtëzakonisht të madh edhe në ndërtimin e imazhit pozitiv të Republikës së Kosovës në raport me shtetet e tjera.

Megjithëse në periudhën e administrimit ndërkombëtar në Kosovë diaspora kishte mbetur pa ndonjë fokus interesi institucional, tani është arritur vetëdijesimi për potencialin e angazhimit të diasporës, por që, në të vërtetë, nuk e nënkupton vetëm vijën njëdrejtimëshe të përfitimit.

Për këtë arsye, si shumë vende të botës, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të prioriteteve të saj, e ka vendosur nevojën për të ndjekur një rol më aktiv në lidhje me diasporën, në mënyrë që edhe këtë pjesë të shoqërisë ta përfshijë në zhvillimin e atdheut.

III. HYRJE

Ndonëse që nga Pavarësia e Kosovës janë bërë disa përpertime sa i përket krijimit të një fryme përkrahëse të Qeverisë së Kosovës ndaj diasporës, të cilat kryesisht kanë pasur në fokus miratimin e legjislacionit të nevojshëm për krijimin e vijave institucionale të komunikimit, megjithatë për të arritur në një situatë të kënaqshme ende duhet të punohet.

Dokumenti më i lartë juridik dhe politik i vendit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, i obligon institucionet e shtetit t'i mbrojnë interesat e shtetasve të saj që jetojnë jashtë territorit të vet. Për t'u kujdesur në mënyrë sa më të organizuar për të mirën e shtetasve që jetojnë jashtë territorit të saj, Qeveria e Republikës ka marrë edhe një sërë hapash, duke miratuar ligje, si: Ligji i Diasporës dhe i Mërgatës, Ligji i Shtetësisë, Ligji për Shërbimet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet Nacionale dhe një varg ligjesh të tjera.

Ligji nr. 04/L-095 i Diasporës dhe Mërgatës, në nenin 4, parag. 1.11, përcakton që Ministria e Diasporës përgatit, koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën. Por, njëra nga sfidat më mëdha, me të cilën Qeveria e Kosovës në të ardhmen mund të përballet karshi diasporës është krijimi i kushteve për përfaqësimin e diasporës në Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpërmjet rezervimit të ulëseve në të. Një gjë e tillë është kërkuar në shumicën e takimeve që Ministria e Diasporës i ka realizuar me bashkatdhetarët kosovarë pothuajse në të gjitha shtetet evropiane, në SHBA dhe në Kanada.

Aktualisht, mundësia e institucioneve kosovare për t'iu përgjigjur plotësisht të këtyre kërkesave mbetet e paktë. Kjo ndodh për shkak se një gjë e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila nuk mund të bëhet në një periudhë afatmesme. Megjithatë, gjetja e mundësisë dhe e mënyrës së përfaqësimit të diasporës mbetet një prioritet për të ardhmen. Në këtë aspekt, është bërë një iniciativë fillestare: Ministria e Diasporës i është adresuar me një kërkesë Komisionit parlamentar për reformën kushtetuese dhe zgjedhore që diasporës t'i rezervohen 5 vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Siç përcaktohet edhe në Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme 2014– 2016, politikat në shërbim të diasporës do të vazhdojnë të jenë për ngritjen e kapaciteteve, mbështetjen, ruajtjen e identitetit, organizimin e mësimit plotësues, nxitjen e investimeve të diasporës në vend, etj. Në këtë fushë, projektet dhe aktivitetet në planin afatmesëm janë: në periudhën e ardhshme afatmesme parashihet krijimi i regjistrit të diasporës, vazhdimi i hapjes së qendrave kulturore të Kosovës në diasporë, hapja e seksionit të muzeut të diasporës dhe mërgatës në Kosovë, në kuadër të Muzeut Kombëtar, etj.

IV. BAZA JURIDIKE DHE LIGJORE

Përveç adresimit të nevojave të diasporës dhe prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën është hartuar duke u mbështetur dhe në përputhje me një numër aktesh normative të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Ato janë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji i Diasporës dhe i Mërgatës nr. 04/L-095;
- Ligji i Shtetësisë së Kosovës nr.03/L-034;
- Ligji për Shërbimet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, nr.03/L-125;
- Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (për Kuvendin e Republikës së Kosovës) nr.03/L-73;
- Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2014-2016 e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Vendimi i Ministrisë së Diasporës për hartimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën, si dhe disa rregullore dhe udhëzime të tjera administrative.

V. PARIMET E PËRGJITHSHME

Aktivitetet e ndërmarra nga të gjithë aktorët relevantë në Kosovë, në përputhje me Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën, do të bazohen në parimet e përgjithshme të mëposhtme:

Parimi i Kushtetutshmërisë: - kërkon nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të kujdesen maksimalisht për interesat e popullit të Kosovës, pa marrë parasysh a jetojnë brenda apo jashtë territorit të vendit. Në këtë pikëpamje, institucionet e Republikës së Kosovës do të vazhdojnë të kenë kujdes dhe të përkrahin çdo nevojë që ka diaspora.

Parimi i Ligjshmërisë: - kërkon nga të gjitha institucionet e Kosovës, si në nivelin qendror, ashtu edhe lokal, që ta respektojnë çdo veprim brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre, sa i përket forcimit dhe përkrahjes së diasporës; amendamenti i ligjeve ekzistuese ose nxjerrja e ligjeve të reja që do të forconin përkrahjen dhe kujdesin për diasporën.

Vullneti politik: - kërkon nga autoritetet politike të demonstrojnë në mënyrë efektive mundësinë e krijimit të një komisioni të veçantë parlamentar për diasporën, i cili do t'i adresonte në Kuvendin e Republikës së Kosovës të gjitha çështjet që janë me interes për të.

Parimi i mundësisë së votimit: - kërkon nga autoritetet shtetërore të Kosovës që të krijojnë kushte dhe mundësi për votim të anëtarëve të diasporës. Një gjë të tillë e parasheh edhe Ligji për Zgjedhjet, i cili saktësisht përcakton se të drejtë vote kanë shtetasit e Republikës, si dhe ata që jetojnë jashtë territorit të saj.

Parimi i mundësisë në vendimmarrje: - kërkon pjesëmarrje aktive të diasporës në proceset vendimmarrëse dhe të politikëbërjes nëpërmjet konsultimeve, dëgjimeve publike ose aktiviteteve të ngjashme. Të gjitha ligjet, strategjitë, planet zhvillimore ose dokumente të ngjashme që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë te diaspora ose janë me interes të veçantë për të, paraprakisht, para se të miratohen dhe të hyjnë në fuqi, duhet të diskutohen me diasporën.

Parimi bashkëpunues: - u bën thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të saj përkatës të veprimit për të bashkëpunuar në mirëbesim dhe në përputhje me objektivat e masat e miratuara, të cilat kërkojnë bashkëpunim ndërinstitutional.

Parimi i gjithëpërfshirjes: - kërkon nga institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe nga mekanizma të tjerë ta japin maksimumin për përmirësimin dhe përparimin e bashkëpunimit me diasporën; po ashtu kërkon nga shoqëria kosovare brenda territorit të Republikës që të vazhdojë t'i mbajë lidhjet e forta me anëtarët e tjerë të familjes, të cilët gjenden nëpër diasporë. Nëpërmjet mbajtjes së lidhjeve të forta, çdo qytetar i Kosovës kontribuon në ruajtjen e kulturës, gjuhës, traditës dhe zakoneve të vendit të origjinës.

VI. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË

Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-095 të Diasporës dhe Mërgatës, në bashkëpunim me institucionet e tjera publike dhe organizatat e shoqërisë civile, Ministria e Diasporës e ka përgatitur Projekt-Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën për periudhën 2013-2018.

Procesi ka filluar me konsultimet paraprake që janë bërë me aktorët e ndryshëm institucionalë dhe të shoqërisë civile për hartimin e një plani për konceptimin e një projekti paraprak të prioritetëve kryesore.

Me qëllim të konceptimit të këtij dokumenti, nga data 31.1 – 2.2.2013 është organizuar punëtorja e parë, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Diasporës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Instituti Albanologjik, Universiteti i Prishtinës, Radio Televizioni i Kosovës, përfaqësues nga diaspora, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Doganat e Kosovës, përfaqësuesit e OJQ-ve, si DfD, D4D, RIINVEST, Aleanca Kosovare e Biznesit, Oda Ekonomike Amerikane, përfaqësues nga organizatat donatore ndërkombëtare, si: IOM-i, UNDP-ja dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

Punëtorja është ndihmuar nga 4 këshilltarë të financuar nga UNDP-ja, të cilët ua kanë lehtësuar punën 4 grupeve të punës, që kanë punuar në përgatitjen e 4 shtyllave të Projekt-strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën.

Meqenëse dokumenti i referohet diasporës, Ministria e Diasporës ka dizajnuar një proces të konsultimeve intensive me diasporën në vendet ku jeton dhe vepron. Për këtë qëllim, janë organizuar konsultimet publike në Gjermani (Munih, Shtutgart, Dyseldorf, Hamburg, Hanover, Berlin), Zvicër (Cyrih dhe Gjenevë), Belgjikë (Bruksel), Francë (Paris), Slloveni (Lubjanë), Kroaci (Zagreb), Austri (Vjenë dhe Linc), Suedi (Malmo), Norvegji (Oslo), Finlandë (Helsinki), Itali (Trevizo), Kanada (Hamilton) dhe SHBA (Nju-Jork dhe Çikago).

Nga këto takime janë përgatitur raportet me rekomandimet e marra nga diaspora, të cilat janë diskutuar në kuadër të Komisionit për hartimin e Projekt-strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën në punëtorinë e dytë, e mbajtur nga dt. 20.5 - 24.5.2013. Në këtë punëtori, në të cilën kanë marrë pjesë aktorët e përmendur në punëtorinë e parë, janë diskutuar raportet përkatëse, së bashku me rekomandimet e paraqitura nga një këshilltar i angazhuar nga IOM-i.

Nëpërmjet metodologjisë së diskutimit të hapur dhe angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve janë finalizuar përfundimisht katër objektivat e përgjithshme dhe objektivat strategjike, duke i bashkuar kështu edhe rekomandimet dhe idetë e aktivistëve, përfaqësuesve dhe të

profesionistëve të diasporës, që do të ndihmojnë për arritjen e objektivave reale për zbatimin e strategjisë.

Gjatë gjithë procesit të hartimit të Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën, janë marrë parasysh edhe aktet e tjera ligjore dhe strategjike, si dhe prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të përmbledhura në Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme 2014– 2016, si dhe hulumtimet e bëra nga mekanizmat e ndryshëm, si RIINVEST-i, Banka Qendrore e Kosovës, hulumtimet e bëra nga UNDP-ja, IOM-i, DfD-ja etj.

VII. VIZIONI I STRATEGJISË

Përkrahja e diasporës për forcimin e saj nëpërmjet një sistemi institucional të përgjegjshëm dhe efikas, që do të jetë në gjendje ta ndihmojë atë për ruajtjen e çdo vlere kombëtare. Për të përfituar rezultate të prekshme, por për të krijuar edhe ura të forta bashkëpunimi, që do të demonstrojë realitetin e lidhjes shpirtërore mes diasporës dhe Kosovës.

VIII. MISIONI I STRATEGJISË

Autoritetet shtetërore të Kosovës, në të gjitha nivelet, dhe pjesëmarrësit e tjerë janë të vendosur që t'i përmirësojnë dhe t'i forcojnë lidhjet me diasporën në vijën institucionale. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë ta zhvillojë dhe ta përmirësojë bashkëpunimin me diasporën, ta ndihmojë atë me të gjitha kapacitetet, politike, ligjore e njerëzore, çdo herë kur ka nevojë për atdheun e saj.

IX. ANALIZA E SITUATËS

Nisur nga proporcioni me popullatën e vendit të origjinës, Kosova konsiderohet njëri nga vendet me një diasporë shumë të madhe.

9.1 Etapat dhe arsyet e emigrimit

Banka Qendrore e Kosovës, në një raport të saj të publikuar në vitin 2008, ka bërë një ndarje të etapave të emigrimit të kosovarëve. Nga rreth 800 mijë kosovarë, sa vlerësohet të kenë emigruar në tri periudha, 14% i takojnë emigrimit në vitet 1960-1980, në vitet e 90-ta përfshihen rreth 59% dhe gjatë luftës së viteve 1998/99 përfshihen 27%. Këto të dhëna nuk përfshijnë kohën e emigrimit për në Turqi, gjatë periudhës paraprake.

Nga perspektiva globale supozohet se janë rreth 215 milionë njerëz në botë, të cilët jetojnë në një vend që është i ndryshëm nga ai në të cilin kanë lindur, numër ky që është trefishuar në 30 vjetët e fundit. Ata jetojnë në një botë që është më e globalizuar, më e ndërlidhur dhe më e ndërvarur se më parë. Vendet e ndryshme po e kuptojnë se kjo diasporë përfaqëson një burim të rëndësishëm. Përderisa në të kaluarën pak shtete merreshin me të, tani është interes pothuajse i të gjitha shteteve, të cilat po përpiqen t'i gjejnë mënyrat për lidhjen dhe bashkëpunimin me diasporën.¹

Në këtë kontekst, përveç arsyeve të mobilitetit të madh, që është karakteristikë e shoqërisë moderne, Kosova historikisht ka pasur edhe arsye të tjera që kanë imponuar largimin e një pjese të popullatës së saj në drejtim të vendeve të tjera. Arsyet kryesore konsiderohet të kenë qenë:

- Arsyet politike, të cilat u takojnë periudhave para vitit 1999;
- Arsyet ekonomike dhe sociale, të cilat u takojnë të gjitha periudhave.

Rreth 30% e familjeve të Kosovës kanë një ose më shumë anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit. Rreth 39% e emigrantëve jetojnë në Gjermani, 23% në Zvicër, 6% në Itali, 7% në Austri, 4% në Britani të Madhe, 5% në Suedi, dhe 3.5% në SHBA, ndërsa nga 2% në Francë, Kanada dhe Kroaci². Diaspora e Kosovës do të mund të ndahej në tri periudha (bazuar në kohën e emigrimit):

- Periudha nga vitet e 60-ta deri në vitet e 80-ta, që përfshinë rreth 14% të emigrantëve;
- Periudha e viteve të 90-ta, që përfshin rreth 59% të numrit të përgjithshëm të emigrantëve; dhe

¹ <http://diasporamatters.com/why-diaspora-matters/>, 18.05.2013.

² Raporti i fundvitit 2008 i Bankës Qendrore të Kosovës (Ky raport nuk përmban të dhëna për diasporën Turqi)

- Gjatë luftës, rreth 27% e diasporës ka migruar nga Kosova.

Pjesa më e madhe e diasporës, rreth 60%, janë qytetarë të vendeve ku ata jetojnë, rreth 34% kanë qëndrim të përkohshëm (2-10 vjet), prej të cilave 1.3% kanë vizë për studime. Pjesa e mbetur prej 6% nuk kanë status të përcaktuar³.

Supozohet se rreth një e treta e numrit të përgjithshëm të kosovarëve jetojnë jashtë vendit⁴. Ky numër është shumë më i madh, nëse merren parasysh edhe ata që jetojnë në Turqi ose në vende të tjera.

Por, nuk ka një regjistër të saktë zyrtar për numrin e diasporës sonë: ku jetojnë, mosha, gjinia, niveli i arsimit, gjendja e tyre sociale ose potenciali i tyre investues në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar Koncept-dokumentin, i cili hap rrugën për fillimin e procesit të hartimit të regjistrit të mërgatës, ndërsa Ministria e Diasporës është duke e përgatitur planin për jetësimin e këtij projekti.

9.2 Përfaqësimi politik dhe pjesëmarrja në vendimmarrje

Ndonëse një numër shumë i madh i deputetëve të Kosovës vijnë nga diaspora, megjithatë në kuptimin e përfaqësimit ata nuk e përfaqësojnë diasporën.

Nga konsultimet publike me diasporën, duket se ka qenë një disponim i një pjese të saj për të qenë e përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpërmjet vendeve të rezervuara, sikundër që ka pasur zëra se kjo vetëm do të shkaktonte përçarje dhe politizim të këtij komuniteti.

Praktikën e përfaqësimit politik të diasporës në Kuvendin e tyre tashmë e zbatojnë edhe disa vende të rajonit. Republika e Maqedonisë dhe ajo e Kroacisë kanë caktuar ulëse për diasporën në parlamentet e tyre. Shqipëria e ka krijuar Institutin Nacional për Diasporën, ndërsa shtetet e rajonit kanë themeluar një komision të veçantë parlamentar për çështje të diasporës. Praktikën e rezervimit të vendeve në parlament për diasporën e tyre e kanë ndjekur edhe disa vende të botës.

Aktualisht, mundësia e institucioneve kosovare për t'iu përgjigjur plotësisht të këtyre kërkesave mbetet e paktë. Kjo gjë ndodh për shkak se një gjë e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila nuk mund të bëhet në një periudhë afatmesme. Megjithatë, gjetja e mundësisë dhe e mënyrës së përfaqësimit të diasporës mbetet një prioritet për të ardhmen. Në këtë aspekt, është bërë një iniciativë fillestare: Ministria e Diasporës i është adresuar me një kërkesë Komisionit

³ Raporti i fundvitit 2008 i BQK.

⁴ Raporti i Fundvitit 2008 – BQK.

parlamentar për reformën kushtetuese dhe zgjedhore që diasporës t'i rezervohen 5 vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i takon pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në politikëbërje, Qeveria e Kosovës tashmë e ka themeluar Ministrinë e Diasporës që, nëpërmjet këtij mekanizmi, të adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me diasporën. Ndër mekanizmat e rëndësishëm, përveç vetë themelimit të Ministrisë së Diasporës, është edhe hartimi dhe miratimi i Ligjit të Diasporës dhe Mërgatës. Si rezultat, ka filluar procesi i hapjes së qendrave kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën. Në komunat e Kosovës janë emëruar zyrtarë për diasporën, të cilët do t'i ndihmojnë mërgimtarët tanë, duke u ofruar këshilla në fusha të ndryshme të interesit për ta dhe për t'ua lehtësuar kryerjen e disa shërbimeve që ofrojnë komunat.

9.3 Ruajtja e identitetit kulturor dhe e gjuhës

Ruajtja e identitetit kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të diasporës mbetet qëllimi kryesor. Sipas përvojave të shumë vendeve, në procesin e ruajtjes së identitetit kulturor të popullit, në një kontekst tjetër kulturor dhe gjeografik, gjuha duhet të jetë mjet i rëndësishëm i investimit dhe i fokusimit nga institucionet e Republikës të Kosovës.

Me projekte specifike të programeve edukative dhe kulturore mund të pengohet asimilimi i mëtutjeshëm në aspektin gjuhësor, veçanërisht i brezave të dytë dhe të tretë në diasporë.

Rreth 20.000 fëmijë përfitojnë në forma të ndryshme nga organizimi i të mësuarit të gjuhës shqipe. Si potencial ka rreth 400 mësues që punojnë në shkolla me mësime plotësues. Bashkëpunimi rajonal, siç është rasti me Republikën e Shqipërisë, mund të jetë një alternativë e dobishme në qasjet strategjike, pasi sjell një sinergji dhe ulje të kostos së aktiviteteve eventuale.

Hëpërhë, përfshirja më e madhe e diasporës në mësimin plotësues të gjuhës shqipe është në shtetet skandinave (Suedia dhe Finlanda). Një nga faktorët e kësaj përfshirjeje të lartë është edhe përkrahja e dhënë nga institucionet shtetërore ku jeton diaspora.

Krijimi i programeve të posaçme që synojnë studentët e diasporës do të mundësonte ruajtjen e identitetit dhe, njëkohësisht, mbajtjen e lidhjeve mes vendlindjes dhe diasporës. Vendet e ndryshme, si Armenia dhe Kroacia, parashohin lehtësime të ndryshme për pjesëtarët e diasporës që vendosin t'i kryejnë studimet në vendin e origjinës ose vendosin të kryejnë lëndë të caktuara në universitetet e shtetit amë.

9.4 Integrimi në vendet pritëse

Diaspora e Kosovës duhet të marrë iniciativa më aktive, me qëllim të maksimalizimit të mundësive për perspektivën e vet integruese në vendet ku jeton. Por, numri i madh i shoqatave dhe i organizatave, për më tepër mungesa e koordinimit ndërmjet tyre mund t'i dëmtojë në masë të madhe mundësitë reale organizative të diasporës.

Do të ishte një vlerë e shtuar sikur Ministria e Diasporës t'i ofronte ndihmë diasporës për ta fuqizuar organizimin e saj. Në këtë kontekst, krijimi i rrjetit të organizatave, shoqatave dhe mënyrave të tjera në formën e federatave ose të konfederatave, në koordinim të qendrave kulturore të Kosovës, do të mundësonte organizimin shumë më të mirë të diasporës së Kosovës dhe do ta fuqizonte bashkëpunimin me autoritetet relevante në nivel qendror, rajonal dhe lokal në vendet ku ata jetojnë, si dhe avancimin e kontakteve të drejtpërdrejta me ta.

Ky proces do të mundësohej dhe do të lehtësohej në masë të madhe edhe në saje të lidhjes së marrëveshjeve ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe shtetit ku jeton dhe vepron diaspora.

9.5 Potenciali dhe perspektiva e diasporës në zhvillimin ekonomik

Diaspora kosovare është një faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Megjithatë, ky potencial ende mbetet jo sa duhet i shfrytëzuar dhe i kanalizuar në aktivitetet produktive që do të kishin efekte zinxhirore ekonomike. Nga studimi për remitencat, i bërë nga UNDP-ja për vitin 2012, rezulton se 25% e amvisërive në Kosovë pranojnë remitencat në para të gatshme dhe mallra e shërbime. Të dhënat statistikore në Kosovë tregojnë se diaspora dërgon rreth 600 milionë € në vit (Rinvest, 2012). Sipas të njëjtit burim, gjysma e remitencave në para të gatshme janë përdorur për konsum, 18% janë përdorur për ndërtimin e shtëpive dhe për riparime, 17% për qëllime shëndetësore, 15% për arsim dhe vetëm një pjesë modeste, prej 3%, përdoret për investime. Shifra prej 3% pothuajse është e njëjtë me të dhënat e UNDP-së (2012), që tregon se vetëm një pjesë shumë e vogël e remitencave të pranuar në para të gatshme investohet në aktivitete prodhuese/ndërmarrëse (më pak se 4%).

Sipas raportit të UNDP-së (2012), shumica e investimeve nga remitencat ka të bëjë me blerjen e pronave të paluajtshme për shfrytëzim personal (59.8%) dhe me bizneset familjare (23.3%). Investimi në sektorin e shërbimeve arrin në 5.6% të investimeve të përgjithshme, ndërsa emigrantët nuk investojnë fare në sektorin e prodhimit. Arsyes kryesore pse emigrantët nuk planifikojnë të investojnë në vendin tonë, sipas studimit të Rinvestit, janë mungesa e informacioneve nga institucionet për mundësitë e investimit, korrupsioni dhe politikat e pafavorshme fiskale.

Në raportin e vitit 2012 të Bankës Botërore për "Të bërit biznes", Kosova për herë të parë, që prej përfshirjes së saj në këtë raport, shënon progresin më të madh në rangimin e listës prej 185 shteteve të botës. Në krahasim me vitin 2011, kur Kosova ishte në pozitën 117, në raportin e vitit 2012 vendi ynë renditet në vendin e 98-të për të bërit biznes, duke shënuar kështu një ngritje për 19 pozita më lart në raportin më cilësor të indikatorëve në të bërit biznes.

Në këtë raport vlerësohet se Kosova ka arritur progres në fillimin e biznesit, duke eliminuar kërkesën për kapital fillestar, pagesën për regjistrim të biznesit, është forcuar mbrojtja e investitorëve dhe është përshpejtuar e thjeshtësuar procesi për regjistrimin e biznesit. Mbrojtja e investitorëve është ngritur për 74 pozita më lart, që është ngritja më e madhe krahasuar me indikatorët e tjerë të këtij raporti. Ndërkaq, progres është shënuar edhe në fillimin e biznesit nga renditja 168, sa ishte në vitin 2011, në 126, si dhe tregtia nëpërmes kufijve është ngritur 7 pozita më lart.

Vlerësimi i këtij raporti bazohet në 11 indikatorë: fillimi i biznesit, marrja e lejes për ndërtim, sigurimi i energjisë elektrike, regjistrimi i pronës, marrja e kredisë, mbrojtja e investitorëve, pagesa e taksave, zbatimi i kontratave, zgjedhja e pamundësisë së borxhit, tregtia përmes kufijve dhe punësimi i punëtorëve.

Mungesa e statistikave zyrtare paraqet një sfidë për të bërë studime dhe analiza specifike që përbëjnë bazën e politikëbërjes. Të dhënat për investimet nga diaspora figurojnë në kuadër të investimeve të huaja në Kosovë, andaj pak mund të thuhet se sa realisht ka investime në Kosovë.

Në anën tjetër, duhet të krijohet një pako e lehtësive specifike për investitorët potencialë nga diaspora, që do të shërbente për t'i kanalizuar remitencat në aktivitete ndërmarrëse dhe produktive.

Nëpërmjet një mekanizmi stimulues, efektet e politikave stimuluese, në njërën anë, do të ndikonin në rritjen e investimeve produktive në biznes në Kosovë, ndërsa në anën tjetër do të kontribuonin që, nëpërmjet rrjetëzimit të firmave të pjesëtarëve të diasporës në Kosovë, të shërbenin si urë lidhëse që të rritet eksporti i produkteve kosovare në tregjet evropiane dhe në ato botërore.

X. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË STRATEGJISË

Këto objektiva në masë të madhe janë pjesë e pandashme e zhvillimit të politikave që ka ndjekur Qeveria e Kosovës dhe veçanërisht Ministria e Diasporës, për të siguruar avancimin e pozitës së diasporës në vendimmarrje, ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditës së vendit të origjinës, si dhe krijimin e kushteve dhe mundësive më të mira për një treg të favorshëm për hapjen e bizneseve të reja nga diaspora në Kosovë.

Për më tej, këto objektiva të strategjisë i përcaktojnë mbajtësit e punëve dhe të aktiviteteve, të cilat brenda periudhës pesëvjeçare (2013-2018) duhet t'i krijojnë kushtet e nevojshme për promovimin sistematik të vlerave të këtij komuniteti dhe do ta përkrahin atë për t'i gjetur format më të mira të organizimit dhe të komunikimit me vendin e origjinës dhe me vendet ku jetojnë, si dhe të iniciojë potencialin e saj krijues në projekte me interes të përbashkët.

XI. PROMOVIMI DHE AVANCIMI I TË DREJTAVE POLITIKE DHE SOCIALE TË DIASPORËS

Për t'i adresuar nevojat dhe sfidat e identifikuar të këtij objekti, janë identifikuar objektivat strategjike si në vijim:

11.1 Krijimi i kornizës insitucionale për përfaqësim politik të diasporës dhe pjesëmarrje në vendimmarrje dhe politikbërje

Nga konsultimet publike me diasporën, duket se ka qenë një disponim i një pjese të saj për të qenë e përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpërmjet vendeve të rezervuara, sikundër që ka pasur zëra se kjo vetëm do të shkaktonte përçarje dhe politizim të këtij komuniteti.

Aktualisht, mundësia e institucioneve kosovare për t'iu përgjigjur plotësisht të këtyre kërkesave mbetet e paktë, për faktin se një gjë e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila nuk mund të bëhet në një periudhë afatmesme. Megjithatë, gjetja e mundësisë dhe e mënyrës së përfaqësimit të diasporës mbetet një prioritet për të ardhmen.

Për sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe politikbërje, Qeveria e Kosovës tashmë e ka themeluar Ministrinë e Diasporës, nëpërmjet së cilës të adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e bashkëpunimit institucional me diasporën. Në hartimin e këtij dokumenti, diaspora ka qenë e përfshirë nëpërmjet konsultimeve që janë mbajtur gjithandej nëpër botë. Megjithatë, kjo strategji krijon mundësi edhe më të forta për sa i përket përfshirjes së diasporës në politikbërje dhe në vendimmarrje.

Masat e planifikuara:

- Ministria e Diasporës të bëjë kërkesë te Komisioni për media, arsim, rini, kulturë, qeveri lokale dhe diasporë që të iniciojë mundësinë e ndryshimit të rregullores së Kuvendit dhe të mundësohet themelimi i një komisioni të veçantë për diasporën në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Institucionet kompetente të krijojnë mundësi ligjore dhe praktike për themelimin e një baze të dhënash, për të lehtësuar pjesëmarrje më të madhe të diasporës në proceset zgjedhore, krijimi i mundësive për diasporën të votojë në misionet diplomatike dhe konsullore.
- Të sigurohet pjesëmarrja aktive e diasporës në proceset vendimmarrëse dhe të politikëbërjes nëpërmjet konsultimeve, dëgjimeve publike ose aktiviteteve të ngjashme.
- Të gjitha ligjet, strategjitë, planet zhvillimore ose dokumente të ngjashme, që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë te diaspora ose janë me interes të veçantë për të, paraprakisht duhet të diskutohen me diasporën, para se të miratohen dhe të hyjnë në fuqi.

11.2 Krijimi i regjistrit të diasporës

Ndonëse besohet se një e treta e qytetarëve tanë jetojnë jashtë territorit të saj, Kosova ende nuk e ka regjistrin zyrtar për numrin e diasporës së saj. Deri tani ka disa të dhëna tentative, sipas të cilave rreth 800 mijë kosovarë jetojnë në vende të ndryshme të botës, shumica prej tyre në Evropën Perëndimore dhe në SHBA. Po ashtu, mendohet se rreth 1 milion njerëz me origjinë nga Kosova jetojnë në Turqi. Për të pasur një pasqyrë të saktë, Strategjia parash:

Masat e planifikuara:

- Ministria e Diasporës, në bazë të Ligjit të Diasporës dhe Mërgatës, në bashkëpunim me institucionet, siç është Agjencia e Statistikave të Kosovës, duhet ta hartojë regjistrin për diasporën dhe mërgatën. Regjistri duhet të përmbajë të dhëna gjithëpërfshirëse, si: numrin e bashkatdhetarëve, moshën, gjininë, arsimimin dhe aftësimin profesional, gjendjen sociale, shtetin dhe qytetin ku jetojnë, arsyet e emigrimit etj.

11.3 Përmirësimi i shërbimeve ndaj diasporës nëpërmjet fuqizimit të zyrave/zyrtarëve për ndërlidhje me diasporën

Si rrjedhojë e fluksit të madh në stinën e verës, kur pjesëtarët e diasporës janë të pranishëm në atdheun e tyre, shpeshherë janë bërë ankesa për sistem joefikas të shërbimeve komunale për diasporën. Deri tani, autoritetet kosovare kanë marrë disa hapa për shtimin e efikasitetit lidhur me ofrimin e shërbimeve për diasporën. Megjithatë, Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- Komunitat e Kosovës do të marrin masa shtesë që në stinën e verës, kur edhe fluksi i diasporës në Kosovë është më i madh, ta shtojnë efikasitetin e punës, në mënyrë që pjesëtarëve të diasporës t'u ofrojnë shërbime më të shpejta.
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për diasporën që të mund të ofrojnë informata dhe këshilla më të efektshme për diasporën.
- Lehtësimi i procedurave për marrjen e dokumenteve dhe i shërbimeve të tjera të nevojshme në stinën e verës për diasporën.
- Realizimi i fushatave informative për mundësinë që aktualisht institucionet qendrore dhe komunitat e Kosovës ofrojnë nëpërmjet shërbimeve elektronike.

11.4 Lehtësimi i kthimit të pensionistëve dhe të tjerë

Kosova ka një numër jo të vogël të qytetarëve të saj që me dekada jetojnë në vendet e ndryshme të botës. Si rrjedhojë, shumë persona tashmë janë pensionuar. Ka indikacione se një pjesë e madhe e tyre janë të detyruar të jetojnë në vendet ku kanë punuar ose të udhëtojnë shumë shpesh për ta gëzuar të drejtën e pensionit. Kuvendi i Kosovës, me një rezolutë, ka vendosur që të gjitha marrëveshjet e lidhura në kohën e Jugosllavisë për pensione dhe sigurime sociale të vazhdojnë të aplikohen edhe nga Republika e Kosovës. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, aktualisht, është duke negociuar 7 marrëveshje të reja për sigurimet sociale, të cilat pritet të nënshkruhen gjatë vitit 2013, ndërsa Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- Qeveria e Kosovës të krijojë lehtësi për bashkatdhetarët e pensionuar që duan të kthehen e të jetojnë në Kosovë. Ministria e Diasporës të bashkëpunojë me Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, me Ministrinë e Punëve të Jashtme për negociimin dhe lidhjen e marrëveshjeve me shtetet përkatëse për pensione dhe sigurime sociale.

XII. RUAJTJA E IDENTITETIT DHE FUQIZIMI I LIDHJEVE ME DIASPORËN

Për t'i adresuar nevojat dhe sfidat e identifikuar të këtij objekti, janë identifikuar objektivat strategjike si në vijim:

12.1 **Ruajtja e gjuhës amtare nëpërmjet programeve edukative-arsimore dhe kulturore për diasporën**

Republika e Kosovës ka marrë një sërë hapash për të ruajtur gjuhën amtare të pjesëtarëve të diasporës së saj. Meqë gjuha shqipe është njëra nga gjuhët më unike në botë, nëpërmjet programeve të ndryshme, Kosova i ka shtuar përpjekjet e saj për ruajtjen e gjuhës sidomos tek të rinjtë që kanë lindur dhe shkollohen në vende të ndryshme të botës.

Rreth 20.000 fëmijë përfitojnë në forma të ndryshme nga organizimi i të mësuarit të gjuhës shqipe, nëpërmjet afro 300 mësuesve që punojnë në shkolla me mësime plotësues, ndërsa Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- Me qëllim të përfshirjes së një numri sa më të madh të pjesëtarëve të diasporës në mësimin plotësues të gjuhës, nevojitet që arsimi plotësues të jetë pjesë përbërëse e arsimit parauniversitar.
- Bashkërendimi i aktiviteteve me shtetet e rajonit, me interesa të përbashkëta, me qëllim të krijimit të kurrikulës së përbashkët, harmonizimi i rregullativës ligjore, licencimi i përbashkët i mësimeve, financimi i procesit, krijimi i portalit didaktik, furnizimi me tekste shkollore, lektura dhe libra të ndryshëm, organizimi i ekskursioneve shkollore, shkollave (kampeve) verore, dimërore, fushatave vetëdijuese për arsimin plotësues, si dhe aktiviteteve të tjera.
- Zhvillimi i një programi të formatit familjet nikoqire, duke mundur sjelljen e studentëve/nxënësve nga diaspora, në kuptimin e shkëmbimit të njohurive dhe të përvojave nga të dy anët, por edhe me qëllim të ruajtjes së gjuhës për nxënësit dhe studentët e diasporës, të cilët kanë lindur dhe shkollohen në vendet ku jetojnë.
- Krijimi i programeve të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve nga radhët e diasporës.

12.2 Diplomacia publike / promovimi i identitetit shtetëror

Diplomacia publike në kohën moderne është njëri nga elementet kryesore për reflektimin në kuptimin pozitiv të shoqërive të ndryshme për Kosovën, si shteti më i ri në Evropë. Shumë të rinj, të cilët janë rritur në Perëndim, tashmë i kanë krijuar imazhet e tyre pozitive në skenën ndërkombëtare si talentë të shquar në fusha të ndryshme.

Prandaj, për ta popullarizuar më shumë Kosovën si shtet dhe shoqëri me vlera, figurat e njohura që kanë prejardhje nga Kosova do të ndihmohen institucionalisht për ta promovuar Kosovën si shtet, por edhe vlerat e diasporës kosovare. Ky dokument parasheh:

Masat e planifikuara:

- Ministrinë e ndryshme të ndërmarrin iniciativa të ndryshme për të angazhuar personalitete eminente nga diaspora për promovimin e vendit. Një koordinim më i mirë do të mundësonte institucionalizimin e diplomacisë publike nëpërmjet diasporës.
- Inicimi dhe inkurajimi i pjesëtarëve të diasporës që të marrin pjesë në procesin e forcimit dhe njohjes së identitetit shtetëror në vendet ku jetojnë dhe më gjerë.
- Angazhimi i personaliteteve të njohura kombëtare, si: shkencëtarë, artistë, sportistë, afaristë (në grupe) dhe persona të tjerë të suksesshëm për afirmimin e interesave kosovare në skenën ndërkombëtare.

12.3 Avancimi i rolit të medieve në fuqizimin e lidhjeve me diasporën

Mediet janë mjeti qenësor i komunikimit mes diasporës dhe atdheut. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e urave komunikuese dhe bashkëpunuese ndërmjet diasporës dhe Kosovës. Përkrahja e medieve elektronike për të dhënë informacione të sakta dhe profesionale për diasporën është një vlerë e shtuar për reflektimin e realitetit kosovar dhe anasjelltas. Në këtë pikëpamje, Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- RTK-ja, si transmetues publik, ka obligim ligjor që 6-9% të skemës së programit (tokësor dhe satelitor) t'ia dedikojë diasporës. Në këtë aspekt, RTK-ja të ketë një skemë programore të radios dhe të televizionit që do ta përforcojë lidhjen me diasporën.
- Përkrahja e medieve elektronike dhe të shtypura, të udhëhequra nga pjesëtarë të diasporës, të dëshmuara për shërbime të informimit të diasporës, me qëllim të

mbajtjes së lidhjes me vendin dhe që ndihmojnë integrimin e tyre në vendin ku ata jetojnë.

- Qeveria e Kosovës t'i propozojë themeluesit të RTK-së (Kuvendit të Kosovës) që ta ndajë buxhetin adekuat për realizimin e skemës së paraparë programore satelitore kushtuar diasporës.
- Ndryshimi i ligjit për transmetuesin publik-RTK, që të përcaktohet mënyra e financimit të programit satelitor, si dhe të mundësohet përfshirja e një përfaqësuesi të diasporës në bordin e RTK-së.
- Organizatat e gazetarëve, në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës dhe me donatorët, ta themelojnë çmimin vjetor të gazetarisë për shkrimet, kronikat, emisionet dhe zhanre të tjera, për promovimin e vlerave dhe të iniciativave nga diaspora. Dhënia e këtij çmimi do t'i nxitë mediet që t'u kushtojnë një vëmendje të shtuar aktiviteteve të diasporës dhe vlerave të saj.

12.4 Lehtësi për të rinjtë e diasporës që të studiojnë në universitetet e Kosovës

Shkollimi në vendin e origjinës është njëra nga mundësitë esenciale për ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës. Tashmë, Kosova synon që nëpërmjet programeve të veçanta për studentët nga diaspora t'u krijojë atyre lehtësi për të studiuar në universitetet e Kosovës, ku parashihet:

Masat e planifikuara:

- Ministria e Diasporës, MASHT-i dhe universitetet publike do të koordinohen për t'i gjetur modalitetet rreth mundësisë së lehtësive të studimit për studentët e diasporës, për të bërë sigurimin e kuotave për regjistrim në fakultete, organizimin e shkollave verore dhe ofrimin e kurseve të fushave të ndryshme.

12.5 Diaspora dhe shkenca

Shumë herë, mediet raportojnë për studiues të fortë shkencorë që prejardhjen e kanë nga Kosova. Mirëpo, deri tani problemi i mungesës të të dhënave për shkencëtarët e diasporës vazhdon të trashëgohet vit pas viti. Për ta tejkaluar këtë problem, Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- Autoritetet kompetente do të themelojnë programe të veçanta për nxitjen e hulumtimeve shkencore që si temë do të kenë aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me diasporën.

- Identifikimi dhe angazhimi i studiuesve e i shkencëtarëve të profileve të ndryshme, të cilët mund të ftohen nga institucionet e Republikës së Kosovës për t'u angazhuar në projektet e ndryshme shkencore etj.

XIII. INTEGRIMI I PJESËTARËVE TË DIASPORËS NË SHETETET KU JETOJNË

Për t'i adresuar nevojat dhe sfidat e identifikuar të këtij objekti, janë identifikuar objektivat strategjike si në vijim:

13.1 Ndhmë për organizimin e diasporës, me qëllim të lehtësimit të integrimit

Ndonëse pjesa më e madhe e diasporës kosovare është e integruar mirë në vendet pritëse, organizimi i tyre duhet përforcuar edhe më shumë. Autoritetet kosovare do ta japin ndihmën e tyre të rezervë në procesin e integrimit të diasporës në shoqëritë perëndimore, por gjithmonë duke pasur kujdes të shtuar për t'iu shmangur asimilimit. Në këtë pikëpamje, Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- T'i ofrohet ndihmë diasporës për organizimin më të mirë të saj, duke krijuar rrjete të organizatave dhe të shoqatave të diasporës në shtetet ku jeton.
- Ministria e Diasporës do të shërbejë si mekanizëm koordinues që do ta lehtësojë këtë rrjetëzim.
- Themelimi i një kuvendi, i cili do t'i mbledhte përfaqësuesit e rrjeteve/organizatave të diasporës nga vende të ndryshme.
- Ky rrjetëzim i shoqatave dhe i organizatave të diasporës do të ndihmojë për krijimin e një lobi të fuqishëm të Kosovës, dhe me këtë do të ketë përfitime të shumfishta si për Kosovën, ashtu edhe për diasporën, në kuptimin e integrimit të tyre në vendet pritëse.

13.2 Promovimi i të drejtave dhe i obligimeve të pjesëtarëve të diasporës

Diaspora kosovare, sidomos ajo e paarsimuar, mund ta ketë problem të kuptuarit e jetesës dhe pranimit të normave të reja ligjore e sociale në një ambient pothuajse krejtësisht tjetër. Autoritetet kosovare, nëpërmjet qendrave kulturore të Kosovës, do

ta japin ndihmën e tyre në vetëdijesimin e pjesës së diasporës, e cila më me vështirësi integrohet në rregullat normative dhe sociale në një shoqëri tjetër.

Masat e planifikuara:

- Ofrimi i informatave nga qendrat kulturore të Kosovës dhe ambasadat/Konsullatat e Kosovës dhe shoqatat e ndryshme lidhur me të drejtat e pjesëtarëve të diasporës në vendet pritëse.
- Për promovimin e të drejtave dhe obligimeve të diasporës në vendet ku jetojnë do të bëhet ngritja e vetëdijes së tyre nëpërmjet fushatave vetëdijesuese për njohjen e rregullave dhe normave ligjore në shtetet ku jeton diaspora. Duhet të angazhohen personalitete të njohura nga fusha të ndryshme, të cilët kanë ndikim në ato vende ku ka nevojë aktuale për integrimin e kosovarëve. Shembujt e suksesshëm të pjesëtarëve të diasporës duhet t'i motivojnë brezat e rinj në diasporë që të integrohen sa më mirë në vendin ku jetojnë.

13.3 Bashkëpunimi i diasporës me autoritetet përkatëse (në nivel qendror, rajonal e lokal)

Shtetet, në të cilat është e vendosur diaspora kosovare, mund të dallojnë në politikat integruese. Por, autoritetet e Kosovës gjatë kësaj periudhe do t'i zbulojnë dallimet e shteteve për sa i përket integritit të të huajve, në mënyrë që të hartohen planet konkrete se si shteti i Kosovës t'i zgjedhë format dhe modalitet më të lehta për të bashkëpunuar me shtetet përkatëse, për ta ndihmuar diasporën në nxitjen e bashkëpunimit më të mirë me autoritetet e niveleve të ndryshme të shoqërive pritëse.

Masat e planifikuara:

- Kjo strategji do të ndihmojë fuqizimin e bashkëpunimit të diasporës kosovare me autoritetet relevante në nivel qendror, rajonal dhe lokal në vendet ku ajo jeton. Integrimi i të huajve në kontekstin e gjerë nuk realizohet gjithmonë me program qendror, por në shumë raste me programe rajonale, si dhe lokale, si rastet e vendeve skandinave ose rajonet e decentralizuara të Francës etj.
- Inicimi i marrëveshjes ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe institucioneve qendrore, rajonale ose lokale në vendet ku diaspora vepron dhe jeton, me qëllim të integritit të saj më të mirë.

XIV. PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK

Për t'i adresuar nevojat dhe sfidat e identifikuar të këtij objekti, janë identifikuar objektivat strategjike si në vijim:

14.1 Fuqizimi i bashkëpunimit me diasporën për zhvillimin ekonomik të Kosovës

Diaspora luan një rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të atdheut të saj, duke marrë parasysh që shumë afaristë nga diaspora kanë zhvilluar biznese të forta nëpër vende të ndryshme të botës. Në këtë kuptim, sa i përket këtij objekti, Strategjia adreson:

Masat e planifikuara:

- Përkrahja në funksionalizimin e rrjeteve të biznesit, si dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në shqyrtimin dhe hartimin e politikave zhvillimore dhe planeve strategjike për zhvillim ekonomik të Kosovës.

14.2 Promovimi dhe tërheqja e investimeve nga diaspora

Për shkak se Kosova është në fazën e tranzicionit ose në fazën e forcimit të shtetndërtimit, promovimi i tregut të saj për investitorët si të huaj, ashtu edhe të diasporës ende nuk e ka arritur shkallën e merituar. Deri tani ka arritur të promovojë se ka një fuqi punëtore vitale dhe të arsimuar.

Por, për shkak të ekonomisë së shkatërruar gjatë periudhës së okupimit dhe luftës, fuqisë së saj punëtore duket se i mungon përvoja e duhur praktike. Megjithatë, ky nuk është problemi kryesor sa janë problemet me energjinë elektrike dhe garancitë e forta shtetërore që kërkojnë bizneset e mëdha. Megjithatë, Kosova është e gatshme t'i tejkalojë këto sfida dhe, si rrjedhojë, kjo strategji parasheh:

Masat e planifikuara:

- Përkrahja e projektit për krijimin e bazës të të dhënave të bizneseve të diasporës në Kosovë.
- MeD-ja, MPJ-ja, MTI/APIK-u dhe MZHE-ja t'i koordinojnë aktivitetet për promovimin e investimeve nga diaspora, përkatësisht ofrimin e shërbimeve mbështetëse të biznesit lidhur me mundësitë e investimeve në Kosovë, si dhe në organizimin e rregullt të forumeve, konferencave dhe panaireve të biznesit në diasporë dhe në Kosovë.
- Në kuadër të qendrave kulturore në diasporë të ngrihen kapacitetet profesionale për dhënien e shërbimeve mbështetëse lidhur me mundësitë e

investimeve në Kosovë (mjedisi i biznesit, ndryshimet ligjore etj.), duke shërbyer si ndërlidhje e investitorëve nga diaspora me komunitetin e biznesit në Kosovë.

- Komunitet e Kosovës ta shtojnë efikasitetin në ofrimin e shërbimeve për investitorët potencialë nga diaspora lidhur me mundësitë e investimeve dhe të bërit biznes në komunën përkatëse.

14.3 Lehtësimi i investimeve për diasporën

Qeveria e Kosovës në vitin 2011, nëpërmjet Planit të vizionit të zhvillimit ekonomik, është zotuar për përmirësimin e të bërit biznes, duke u përkushtuar që ta vendosë Kosovën në top-40 shtetet e raportit të Bankës Botërore "Të bërit biznes në Kosovë" deri në vitin 2014.

Në këtë kontekst, janë marrë disa masa: është eliminuar leja e punës, është reduktuar numri i dokumenteve për import/eksport, regjistrimi i biznesit bëhet pa pagesë, kërkesa për kapital është eliminuar ose reduktuar, mbrojtja e investitorëve nëpërmjet marrëveshjeve ndërshtetërore, marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, nënshkruar në tetor të vitit 2011, për mbrojtjen e investimeve, marrëveshje kjo që, sipas saj, ofron siguri dhe mbrojtje, si dhe trajtim të barabartë dhe të drejtë për bizneset si në Zvicër, ashtu edhe në Kosovë. Garancitë që ka marrë përsipër Qeveria Amerikane për mbrojtjen e investitorëve nga SHBA-të në Kosovë, normat tatimore më të ulëta në rajon. Ndërkaq, Strategjia i adreson këto çështje

Masat e planifikuara:

- Krijimi i fondit garantues të investimeve të diasporës.
- *Letra me vlerë, të cilat kanë për synim diasporën* - Krijimi i letrave me vlerë të diasporës (në disa vende të quajtura edhe si Bonot e Diasporës), me ç'rast Qeveria do të mund të huazonte nga diaspora për investime kapitale në afat të gjatë (shembulli i Izraelit), ndërsa diaspora do të mund të përfitonte nga norma e kthimit.
- Lirimi nga detyrimet e importit për makineri, pajisje dhe lëndën e parë të nevojitur për investime (Amendamenti i Kodit nr. 03/L-109 për doganën dhe akcizat).
- Lirimi nga taksa në korporatë (Amendamenti i Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave nr. 03/L-162).
- Zvogëlimi i numrit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit (Amendamenti i Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110).

- Lehtësimi i procedurave dhe ulja e kostos për përfshirje në energji elektrike.
- Lehtësimi i procedurave për marrjen e tokës publike në shfrytëzim.
- Krijimi i lehtësive kontraktuale me disa shtete, në të cilat jeton pjesa më e madhe e diasporës; marrëveshjet lidhur me evitimin e tatimit të dyfishtë; mbrojtja dhe promovimi i investimeve (nënshkrimi dhe marrëveshjet ndërshtetërore), si dhe garantimi i investimeve të huaja nga shteti i Kosovës.
- Inkurajimi i diasporës për pjesëmarrje aktive në projektet e partneritetit publiko-privat.
- Funksionalizmi i zonave ekonomike/industriale, parqeve të biznesit, parqeve teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit.
- Promovimi i praktikave të mira dhe i shërbimeve për të gjetur bashkinvestitorë nga Kosova. Një praktikë e mirë është programi “Encouraging Young Entrepreneurs” - EYE. Përkrahja dhe inicimi i projekteve për organizimin e garave për biznes-plan më të mirë, ku ndërmarrës lokalë do t’i paraqitnin idetë e tyre të biznesit para ndërmarrësve dhe investitorëve potencialë nga diaspora, që do të rezultonte me bashkinvestim.
- Promovimi i produkteve specifike bankiere për diasporën.
- Një prej mënyrave është marrëveshja e bankave lokale në Kosovë me bankat në vendet e EU-së dhe më gjerë për krijimin e kartelave bankiere të dyfishta, që do të mundësonte dërgimin e shpejtë të remitencave me kosto të ulët dhe, njëkohësisht, edhe do ta lehtësonte qasjen në historikun e klientit jashtë vendit.
- Përkrahja në themelimin e Bankës për diasporën.

14.4 Nxitja dhe promovimi i kthimit të potencialit intelektual

Kosova ka një potencial të shkëlqyer intelektual në diasporë. Njëra nga sfidat më të mëdha për zbatimin e këtij dokumenti është kthimi i këtij potenciali në vend, për faktin se Kosova ende nuk i ka kapacitetet e mjaftueshme që mund të ofrojnë kushte më të mira për krijuesit e fushave të ndryshme, p.sh. karshi vendeve perëndimore. Por, megjithëkëtë, në këtë aspekt, Strategjia parasheh:

Masat e planifikuara:

- Përgatitja e një registri (Databazë) për profilin profesional të diasporës, i cili do t'i pasqyrojë përparësitë konkurruese të saj në fusha të caktuara të biznesit, shkencës, teknologjisë, shëndetësisë, turizmit etj.
- Funksionalizimi i programit për kthimin e potencialit njerëzor (Brain gain), në bashkëpunim me MASHT-in, UP-në dhe me institucionet përkatëse.
- Fillimi i praktikave nëpërmjet “thirrjeve të hapura” për projekte të promovohen te diaspora. P.sh. fondi për kërkime shkencore duhet të shërbejë për inkurajimin e profesionistëve nga diaspora që të aplikojnë në këto projekte dhe me këtë të bëhet edhe transferi i njohurive dhe i përvojave (“know how”).

XV. MONITORIMI DHE ZBATIMI

Në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe ato strategjike të Strategjisë, Plani i Veprimit është projektuar që të zbatohen objektivat e lartpërmendura nëpërmjet masave specifike dhe konkrete për diasporën, që reflekton në masë shumë të madhe në prioritetet e Deklaratës së Politikave Prioritare Afatmesme 2014– 2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ai përbëhet nga objektivat specifike dhe masat që do të ndërmerren nga institucionet përkatëse, së bashku me treguesit e suksesit që do të jenë të prekshëm, afatet kohore të qarta dhe realiste.

MeD-ja është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollimin e zbatimit të Strategjisë nëpërmjet masave të parashikuara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën. Duke pasur parasysh që Republika e Kosovës për herë të parë nxjerr një dokument të tillë dhe për të rritur efikasitetin dhe përgjegjësinë e institucioneve për zbatimin e masave nga Plani i Veprimit, procesi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të riorganizohet dhe do të bazohet në premisat e mëposhtme:

MeD-ja, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile dhe mediet (RTK) që do të ngarkohen për t'i zbatuar masat e planit të veprimit, në një afat të shkurtër kohor nga miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit duhet ta hartojnë planin e detajuar të punës për zbatimin vjetor të secilës masë. Ky plan pune duhet të bëhet pjesë integruese e planit vjetor të punës së secilit institucion dhe të miratohet nga udhëheqësit e tyre.

Nënkuptohet se duhet të sigurohet mbështetja e duhur financiare për zbatimin e masave të përcaktuara, por mund të kërkohet ndihmë edhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Institucionet e përfshira për zbatimin e masave duhet të përqendrohen në realizimin e efektshëm të masave të marra dhe, në këtë kuptim, do t'i përgatitin raportet jo vetëm sasiore, por edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e suksesit të identifikuar në Planin e Veprimit. Këto raporte duhet t'i dërgojnë te Ministria e Diasporës, si përgjegjëse kryesore e monitorimit të kësaj strategjie dhe planit të veprimit.

MeD-ja mund ta rishikojë planin e veprimit në baza vjetore, në përputhje me prioritetet dhe nevojat e reja.

Në fund të vitit 2018 duhet të bëhet një vlerësim i ndikimit të kësaj strategjie në promovimin dhe avancimin e të drejtave politike dhe sociale, ruajtjen e identitetit dhe fuqizimin e lidhjeve me diasporën, integrimin e diasporës në shtetet ku jetojnë, lehtësimin e përfshirjes së diasporës në zhvillimin socio-ekonomik. Kjo do të ndihmojë për identifikimin më të mirë të nevojave dhe të prioriteteve të diasporës, si dhe përfshirjen e tyre në dokumentin e ardhshëm strategjik.

Ministria e Diasporës, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do t'i monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me implementimin e strategjisë. Në fund të çdo viti, MeD-ja përgatit një raport progresi për shkallën e realizimit të objektivave, të cilin e publikon dhe e bën të njohur për të gjithë aktorët e interesuar qeveritarë dhe joqeveritarë.

Autoritetet kosovare, pjesëmarrëse në grupet e punës, si dhe QKKDM-ja do të raportojnë periodikisht në MeD, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara. Gjithashtu, të gjitha institucionet relevante, të përfshira si bartëse ose partnere në hartimin e këtij dokumenti, do të jenë të involvuara në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë.

Rezultatet e monitorimit dhe të vlerësimit do të shpërndahen që të bëhet i njohur progresi në zbatimin e SDMPV-ve për arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar në të dhënat dhe gjetjet, ato do të shpërndahen nëpër secilin institucion shtetëror, do të organizohen seminare për nxjerrjen e konkluzioneve dhe të rekomandimeve, por do të bëhen publike, në mënyrë që publiku i gjerë të jetë i njoftuar për rezultatet e arritura.

XVI. PËRFUNDIMI

Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018 dhe Planit i Veprimit janë vendosur në kontekstin e nevojave të Kosovës për diasporën dhe të diasporës për Kosovën. Para së gjithash, përgjegjësia për zbatimin e saj i takon më së shumti Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, çdo institucion, sektor ose profesion i ka detyrat e veta, ndërsa përgjegjësia e veçantë qëndron te Ministria e Diasporës dhe te disa ministri të tjera që janë të përfshira si zbatuese të këtij dokumenti, por edhe te qendrat kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën, angazhimi dhe performanca e të cilave kanë rëndësi vendimtare për suksesin e ruajtjes së diasporës, vazhdimësi e natyrshme si pjesë e shoqërisë kosovare.

Kjo është Strategjia e parë që Qeveria e Kosovës e harton për diasporën. Ky dokument ka qenë i bazuar në një analizë për mesataren e plotë për nevojat aktuale, sikundër që janë diskutuar dhe analizuar në esencë mundësitë juridike dhe ligjore që lejojnë realizimin e objektivave dhe të masave njëkohësisht.

E vetmja gjë që ka mbetur pa u përfshirë në këtë strategji dhe që ka qenë si rekomandim i disa zërave nga diaspora është rezervimi i ulëseve për diasporën në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Në analizën që i është bërë këtij rekomandimi, ka rezultuar se një gjë e tillë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila nuk mund të bëhet në një periudhë afatmesme.

Sido që të jetë, gjetja e mundësisë dhe e mënyrës së përfaqësimit të diasporës mbetet një prioritet për të ardhmen, ndoshta në fazën e parë të rishikimit të Planit të Veprimit.

Megjithatë, në asnjë rrethanë, kjo nuk duhet të zvogëlojë rëndësinë dhe peshën e madhe që kanë masat që janë vendosur, në kuptimin e një ndihme të parrezervë që atdheu do t'i japë diasporës, për forcimin e rolit të saj në vendet ku jeton, ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës, si dhe do t'i lehtësojë maksimalisht rrugët e mundësisë së investimeve për ta ndihmuar forcimin dhe zhvillimin e atdheut.

Në mënyrë që të jetë i suksesshëm procesi i implementimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kërkohet një trajtim serioz dhe i sinqertë, që nënkupton vullnetin dhe efikasitetin e të gjithë mekanizmave, si dhe angazhimin financiar të Qeverisë së Kosovës, por edhe gjetjen e donatorëve ndërkombëtarë.

Plani i veprimit
Për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën
2013-2018

Objektivi Strategjik: 1. Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.1 Krijimi i kornizës institucionale për përfaqësimin politik të diasporës dhe pjesëmarrje në vendimmarrje dhe politikë bërje

Veprimi	Treguesit e Suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Afati kohor për realizim	Burimi financiar	Kostoja vjetore financiare	Komentet
1.1.1. Krijimi Komisionit të veçantë Parlamentar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.	<p>a) është dhënë propozimi për themelimin e Komisionit Parlamentar për Diasporën</p> <p>b) Rregullorja përkatëse e Kuvendit është ndryshuar;</p> <p>c) Komisioni parlamentar për Diasporën i themeluar;</p> <p>d) Komisioni Parlamentar për Diasporën është funksional</p>	MeD, Qeveria, Kuvendi	Shoqëria Civile	K4 – 2014 – 2016	Buxheti i Kosovës	12, 000€	
1.1.2. Rritja e pjesëmarrjes së diasporës në proceset zgjedhore në Kosovë.	<p>a) Lista e votuesve të diasporës është qartësuar dhe krijuar;</p> <p>b) Procedurat për mundësimin e votimit elektronik janë shqyrtuar dhe vendosur;</p> <p>c) Procedurat për mundësimin e votimit fizik të diasporës në ambasadat dhe konsullatat e Kosovës janë shqyrtuar dhe vendosur;</p> <p>d) Pjesëmarrja e diasporës në proceset</p>	KQZ	Kuvendi i Kosovës; Partitë Politike; MPJ; MeD; RTK; Shoqëria Civile.	K1-2014	Buxheti i Kosovës	400, 000 €	

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

	<p>zgjedhore në Kosovë është rritur në raport me zgjedhjet paraprake;</p> <p>e) është realizuar fushata sensibilizuese publike në drejtim të vetëdijesimit të diasporës për mundësitë e votimit.</p>						
<p>1.1.3. Krijimi i një Kuvendi të Përgjithshëm të diasporës me përfshirje edhe të institucioneve të Kosovës.</p>	<p>a) Konferenca për themelimin e Kuvendit të Përgjithshëm të Diasporës është organizuar;</p> <p>b) Kuvendet e diasporës në vendet ku jetojnë janë krijuar;</p> <p>c) Kuvendi i Përgjithshëm i Diasporës (KPD) është themeluar;</p> <p>d) është themeluar sekretariati i KPD - së me seli në Prishtinë;</p>	<p>MeD; Diaspora;</p>	<p>MPJ; MeD; Shoqëria Civile</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Qeveria e Kosovës, donatorë të ndryshëm</p>	<p>130, 000€</p>	<p>Ministria e Diasporës në partneritet me Diasporën angazhon entitete të pavaruara ose organizata/OJQ për të krijuar kushtet dhe të mundësoj mbajtjen e Konferencës së Përgjithshme të Diasporës.</p>
<p>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.2. Krijimi i Regjistrimit të Diasporës</p>							
<p>1.2.1. Vendimi për formimin e Komisionit shtetëror për mbikëqyrjen e procesit të Regjistrimit të Diasporës.</p>	<p>a) Fillimi zyrtarë i projektit për krijimin e regjistrimit të diasporës;</p>	<p>MeD</p>	<p>Qeveria,</p>	<p>K2, K3 – 2013</p>	<p>N/A</p>	<p>N/A</p>	<p>Projekt vendimi është hartuar dhe proceduar ne qeveri për miratim</p>

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>1.2.2. Nxjerrja e një rregulloreje për zbatimin e projektit të krijimi të regjistrit të diasporës.</p>	<p>a) Përgatitja e dokumenteve bazike b) Përcaktimi i bartësve të projektit; c) fushata sensibilizuese; d) Metodologjia e grumbullimit të të dhënave; e) koha e realizimit; f) koha e përpunimit dhe shpërndarjes;</p>	<p>MeD</p>	<p>MPJ; MIE; MPB; Akademia e Shkencave; UP; ASK; MAPL</p>	<p>K3 - 2013</p>	<p>Buxheti i Kosovës,</p>		<p>Është draftuar rregullorja për zbatimin e projektit të krijimit të regjistrit të diasporës</p>
<p>1.2.3. Mbledhja/grumbullimi i të dhënave.</p>	<p>a) është bërë ndarja e aktiviteteve sipas fazave të projektit; b) janë bërë përgatitjet finale para grumbullimit të të dhënave; c) është bërë ndarja e rolit dhe përgjegjësi;</p>	<p>MeD</p>	<p>ASK; MPJ; MPB</p>	<p>K2 - K4 – 2014</p>	<p>Qeveria e Kosovës, donatorë të ndryshëm</p>	<p>Kostoja e procesit të Regjistrimit të Diasporës është proces i ndarë nga Kostoja e zbatimit të këtij Plani të Veprimit.</p>	
<p>1.2.4. Analizimi dhe shpërndarja e të dhënave.</p>	<p>a) është bërë pastrimi i të dhënave; b) janë bërë përgatitjet e raporteve në forma të ndryshme; c) forma e shpërndarjes të të dhënave: në formë të shtypur dhe elektronike;</p>	<p>MeD</p>	<p>ASK</p>	<p>K3 - 2015 deri K2 - 2016</p>	<p>Qeveria e Kosovës, donatorë të ndryshëm</p>		

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.3. Përmirësimi i Shërbimeve ndaj Diasporës, nëpërmjet fuqizimit të zyrave/zyrtarëve për ndërlidhje me diasporën

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>1.3.1. Hapja e sporteleve të veçanta për shërbime administrative për pjesëtarët e diasporës nëpër komunitet e Kosovës.</p>	<p>a) Komunitet e Kosovës të emërojnë zyrtarë të përhershëm për ndërlidhje me diasporën;</p> <p>b) Informimi mbi ofrimin e shërbimeve nga ana e institucioneve qendrore e lokale për diasporën, si në aspektin administrative ashtu edhe në lidhje me kushtet e hapjes së bizneseve dhe investimeve;</p> <p>c) janë caktuar saktë roli dhe detyrat e zyrtarëve përgjegjës për shërbimet ndaj diasporës;</p> <p>d) është bërë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal lidhur me ofrimin e shërbimeve për diasporën;</p>	<p>Komunitet</p>	<p>MeD; MAPL</p>	<p>K1 2014</p>	<p>Buxheti I Kosovës</p>	<p>30,000</p>	<p>Të shikohet mundësia e bartjes nga stafi aktual i komuniteteve Sportelet të jenë kompletë funksional gjatë periudhës korrik-gusht dhe Djetor-Janar</p>
<p>1.3.2. Lehtësimi i qasjes së pjesëtarëve të diasporës në shërbimet administrative në Kosovë.</p>	<p>a) janë shpërndarë kartelat identifikuese për pjesëtarët e diasporës që janë përfshirë në regjistrin e diasporës;</p> <p>b) është bërë ndryshimi, plotësimi dhe përshtatja e legjislacionit përkatës.</p>	<p>MPB, MeD, Komunitet</p>	<p>MPJ, RTK</p>	<p>K1 2014 – K4 2014</p>	<p>Buxheti I Kosovës</p>	<p>0,00 (Kostoja e lëshimit të kartelës identifikuese do të mbulohet nga vetë aplikuesi)</p>	<p>Ky aktivitet ka për qëllim ofrimin e mundësive të pajisjes me dokumente të gjendjes civile për pjesëtarët e diasporës, posaqërisht për ata që vijnë nga shtetet të cilat lëshojnë vetëm një certifikatë origjinale.</p>

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.4. Lehtësimi i kthimit të pensionistëve dhe të tjerë

1.4.1.Lidhja e marrëveshjeve për sigurimet sociale me shtetet përkatëse.	a) janë krijuar mundësitë e kthimit të pensionistëve në vendlindje pa pasoja financiare	MPMS	MPJ; MeD	2014, 2015, 2016			Realizimi I këtij aktiviteti varet edhe nga gatishmëria e shtetit negociues
---	---	------	-------------	---------------------	--	--	---

Objektivi Strategjik: 2. Ruajtja e Identitetit dhe fuqizimi I lidhjeve me diasporën

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.1 Ruajtja e gjuhës amtare nëpërmjet programeve edukative/arsimore dhe kulturore për diasporën

Veprimi	Treguesit e Suksesit	Institucionet përgjegjëse	Institucionet mbështetëse	Afati kohor	Burimi financiar	Kostoja vjetore financiare	Komentet
2.1.1 Mbështetje për shkollat e mësimit plotësues në diasporë për organizimin e mësimin plotësues për fëmijët dhe të rinjtë e diasporës.	a) Numri I teksteve shkollore, lekturave dhe librave të tjerë si dhe mjeteve didaktike të shpërndara; b) Botimi i revistës periodike “URA” c) Numri i mësuesve të diasporës të trajnuar; d) Numri i nxënësve pjesëmarrës në mësimin plotësues;	MeD/QKKDM; MASHT	MPJ, RTK	2014 - 2016	Buxheti i Kosovës	70,000.00	Financimi i gjithë sistemit të mësimin plotësues në diasporë është proces i vecantë i cili do të definohet pas arritjes së Marrëveshjes Ndërshtetërore Kosovë – Shqipëri, për institucionalizimin e mësimin plotësues në diasporë.

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>2.1.2 Krijimi dhe përditësimi i portalit didaktik.</p>	<p>a) Numri i vizitorëve të portalit;</p>	<p>MeD; MASHT,</p>	<p>MAP</p>	<p>2014</p>	<p>Buxheti i Kosovës</p>	<p>10,000.00</p>	<p>Portali Didaktik do të realizohet në bashkëpunim edhe me MASH - Republika e Shqipërisë.</p>
<p>2.1.3 Organizimi i kampeve verore dhe dimërore.</p>	<p>a) Numri i pjesëmarrësve në kampe</p>	<p>MeD, MASHT</p>	<p>Komunat, FSK, MPB, Shoqëria Civile</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti I Kosovës</p>	<p>60,000.00</p>	<p>Ky Projekt realizohet në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë.</p>
<p>2.1.4 Organizimi i ekskursioneve mësimore të nxënësve dhe mësuesve nga diaspora.</p>	<p>Numri i nxënësve dhe mësuesve që marrin pjesë në këtë program.</p>	<p>MeD, MASHT</p>	<p>Komunat, RTK, Shoqëria Civile</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti i Kosovës dhe Donatorët</p>	<p>40,000.00</p>	<p>Ky Projekt realizohet në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë.</p>

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>2.1.5 Organizimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse me rastin e ditëve të diasporës (aktivitete arsimore, kulturore, artistike, sportive, si dhe ndarja e çmimit vjetor për grupin apo mërgimtarin më të suksesshëm të vitit.</p>	<p>Numri I pjesëmarrësve nga diaspora; Numri I aktiviteteve kulturore, artistike e sportive në Kosovë dhe në diasporë; Rritja e kandidaturave për çmimin vjetor të grupit apo mërgimtarit më të suksesshëm;</p>	<p>MeD</p>	<p>MASHT MKRS Universitetet publike, RTK Organizatat dhe shoqatat e diasporës</p>	<p>K3 2014 - 2016</p>	<p>Buxheti I Kosovës</p>	<p>160,000.00</p>	
<p>2.1.6 Binjakëzimi i shkollave në mes shkollave të Kosovës dhe shkollave ku organizohet mësimi plotësues në diasporë.</p>	<p>Numri I shkollave të banjzuara</p>	<p>MeD MASHT</p>	<p>Komunat; Organizatat dhe shoqatat e diasporës</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti I Kosovës</p>	<p>5,000.00</p>	
<p>Masa/Nënoobjektivi Strategjik: 2.2. Diplomacia publike/promovimi i identitetit shtetëror</p>							
<p>2.2.1 Mbështetje për shoqatat dhe organizatat e diasporës në organizimin e ngjarjeve të rëndësishme të</p>	<p>a) Numri i ngjarjeve të organizuara</p>	<p>MeD/QKKDM Ambasadat / Konsullatat</p>	<p>Organizatat dhe shoqatat e diasporës RTK</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti i Kosovës Donatorët</p>	<p>40,000.00</p>	

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

Kosovës në vendet pritëse.							
2.2.2 Përgatitja e programit për përmirësimin e imazhit të diasporës në vendet ku jetojnë.	a) Programi i përgatitur dhe i miratuar.	MeD MPJ	Ministrit e linjës Shoqatat dhe organizatat e diasporës; Donatorët;	2014	Buxheti i Kosovës	30,000.00	Një program i tillë dhe implementimi i tij do të ndikojë në përmirësimin e imazhit të diasporës ku edhe reflektohet edhe imazhi i shoqërisë kosovare

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.3 Avancimi i rolit të medieve në fuqizimin e lidhjeve me diasporën

2.3.1 Shndërrimi i programit Satelitor të RTK-së në kanal të veçantë satelitor për diasporën.	a) Amandamenti i Ligjit për RTK-në; b) përfshirja e së paku një përfaqësuesi të diasporës në Bordin e RTK-së c) caktimi i buxhetit të veçantë për kanalin satelitor në lartësinë prej 6-9% të buxhetit të përgjithshëm të RTK-së d) rritja e stafit profesional për kanalin satelitor; e) zgjerimi i programit të RTK për diasporën	ZKM; Kuvendi	MeD, MPJ, RTK-së	K4 2014 – 2016	Buxheti i Kosovës Donatorët	182,400.00 (për shërbimin - vjetor të transmetimi t satelitor)	Ky aktivitet kërkon ri planifikimin e buxhetit të ndarë të RTK-së, planifikimin e pagesës së transmetimit satelitor dhe ri- sistemimin e stafit të këtij mediumi.
--	---	-----------------	---------------------	-------------------	-----------------------------------	---	---

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>2.3.2 Realizimi I emisioneve radio televizive të dedikuar diasporës</p>	<p>a) Të paktën 50 emisione premierë në vit; b) Të paktën 40 emisione edukative – arsimore për fëmijët në diasporë.</p>	<p>RTK</p>	<p>MeD, MASHT, MPJ, institucionet e tjera publike.</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti I RTK-së dhe Donatorët</p>	<p>370,000.00</p>	<p>Këto seri emisionesh do të prodhohen me idenë e promovimit të storieve të suksesshme të personaliteteve apo grupeve të ndryshme të aktiviteteve të diasporës.</p>
<p>2.3.3 Themelimi i çmimit vjetor të gazetarisë për shkrimet, kronikat, emisionet dhe zhanret e tjera për promovimin e vlerave dhe iniciativave nga diasporës.</p>	<p>a) Nxitja e vëmendjes së mediave për ti kushtuar hapësirë sa më të madhe vlerave dhe aktiviteteve të diasporës;</p>	<p>Organizatat e gazetarëve</p>	<p>MeD; Donatorët ndërkombëtar</p>	<p>K4 2014 – 2016</p>	<p>Donatorët</p>	<p>10,000.00</p>	<p>Ku çmim duhet të jetë I formatit tradicional, ku në fakt përmes storieve afirmative për diasporën do të ketë një pasqyrë më realiste rreth sukseseve të individëve ose grupeve të ndryshme të diasporës</p>

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.4 Lehtësi për të rinjtë e diasporës që të studiojnë në universitetet e Kosovës

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

2.4.1 Caktimi i kuotës për studimeve universitare dhe pasuniversitare për një numër të caktuar të studentëve të diasporës.	a) Numri aplikantëve për të fituar të drejtën studimit në universitetet publike.	MASHT	MeD Universitetet Publike	Në vazhdimësi		0.00	
2.4.2 Zhvillimi i projekteve për student praktikant nga diaspora në institucione publike të Kosovës.	a) Janë identifikuar institucionet që pranojnë praktikantët nga diaspora. b) Angazhimi i së paku 20 praktikantëve nga diaspora.	MeD	Ministrit e linjës; Komunat	K3 2014-2016		0.00	

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.5 Diaspora dhe Shkenca

2.5.1 Organizimi i konferencës shkencore për diasporën dhe mërgatën.	a) Numri i punimeve shkencore të publikuara nga konferenca;	MeD	MASHT; ASHAK; Instituti Albanologjik; Universitetet Publike; RTK;	K4 2014 - 2016	Buxheti i Kosovës	25,000.00	Kjo konferencë do të organizohet çdo dy vite.

Objektivi Strategjik: 3. Mbështetje për integrimin e diasporës në vendet pritëse

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.1: Ofrimi i ndihmës për mobilizimin e diasporës në mbështetje të përpjekjeve integruese

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

Veprimi	Treguesit e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Afati kohor për realizim	Burimi financiar	Kostoja financiare vjetore	Komentet
3.1.1. Mbështetje në krijimin / zhvillimin e shoqatave të diasporës në vendet e përzgjedhura të destinacionit.	a) është mbështetur krijimi i shoqatave të diasporës në së paku tri vende të destinacionit; b) Së paku 10 grante të shpërndara për së paku 10 shoqatat e ndryshme të diasporës.	MeD;	MPJ, MIE, MASHT, MKRS, MPMS, MTI.	2014 - 2016	Buxheti i Kosovës	30,000.00	
3.1.2 Organizimi i takimit të Kuvendit të Përgjithshëm të Diasporës.	a. Takimi Vjetor i realizuar me pjesëmarrjen e së paku 20 shoqatave nga së paku 5 vende të ndryshme.	MeD;	ZKM; MPJ; MIE; MASHT; MKRS; MPMS; MTI; ZP;	K3 2015.	Buxheti i Kosovës	80,000.00	Organizimi i tillë shërben si mjet për dialog mes diasporës dhe Kosovës dhe për krijimin e rrjeteve në mes të shoqatave të diasporës së vendeve të ndryshme.
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.2: Ngritja e ndërgjegjësimit në mesin e diasporës në lidhje me të drejtat dhe obligimet në vendet pritëse							
3.2.1 Ofrimi i informatave lidhur me të drejtat e pjesëtarëve të diasporës në vendet pritëse.	a) Numri i broshurave të ofruara në lidhje me informatat mbi të drejtat dhe detyrimet e diasporës.	MeD / QKKDM, MPJ / Ambasadat dhe Konsullatat,	MKRS; MPJ; MASHT; MPMS; MTI; MIE; Shoqëria Civile.	2014 - 2016	Buxheti i Kosovës	10,000.00	

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>3.2.2. Angazhimi i personaliteteve nga radha e diasporës si dhe të personaliteteve ndërkombëtare nga shteti pritës për promovimin e te drejtave dhe obligimeve të mërgimtarëve në vendet ku jetojnë.</p>	<p>a) Numri i personaliteteve të angazhuara.</p>	<p>MeD</p>	<p>MKRS; MPJ; MASHT; MPMS; MTI; MIE; Shoqatat ne diaspore;</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti i Kosovës dhe donatorët</p>	<p>50,000.00</p>	<p>Ky aktivitete duhet të bëhet në bashkëpunim me personalitete të ndryshme që kanë arritur sukses në diasporë dhe që kanë reputacion të mirë</p>
<p>Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.3: Nxitja e bashkëpunimit të diasporës me autoritete në vendet pritëse</p>							
<p>3.3.1. Thellimi i raporteve ne mes te shoqatave ne diaspore dhe organeve lokale e rajonale.</p>	<p>a) Individ e/organizata te autorizuar per te bashkepunuuar me institucionet lokale e rajonale ne vendin ku diaspora jeton.</p>	<p>MeD</p>	<p>MKRS; MPJ; MASHT; MPMS; MTI; MIE; Shoqatat ne diaspore;</p>	<p>Në vazhdimësi</p>		<p>0.00</p>	
<p>3.3.2. Inicimi i marrëveshjes ndërmjet institucioneve te Kosovës dhe institucioneve qendrore, rajonale e lokale ne vendet ku jeton diaspora për përmirësimin e</p>	<p>a) numri i marrëveshjeve të inicuar në mes institucioneve dhe institucioneve rajonale në vende e ndryshme ku jeton dhe vepron diaspora</p>	<p>MeD</p>	<p>MKRS; MPJ; MASHT; MPMS; MTI; MIE; Shoqatat ne diaspore;</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti i Kosovës</p>	<p>15,000.00</p>	

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

pozitës së diasporës në ato vende.							
---	--	--	--	--	--	--	--

Objektivi strategjik 4: Përfshirja e diasporës në zhvillimin social-ekonomik

Masa/Nënobjektivi 4.1: Forcimi i bashkëpunimit me diasporën në mbështetje të zhvillimit ekonomik në Kosovë

Veprimi	Treguesit e Suksesit	Insitucionet përgjegjëse	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Burimi financiar	Kostoja financiare vjetore	Komentet
4.1.1 Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i rrjeteve të tyre.	a) Rritja e numrit të bizneseve anëtare; b) Numri i pjesëmarrësve nga rrjetet e bizneseve në hartimin e politikave zhvillimore;	MeD	OJQ në Diasporë	K4 2013	Buxheti i Kosovës, Anëtarësia në rrjete	25,000.00	
4.1.2 Botimi i informatorit për bizneset e diasporës "InfoBiz" periodike për mbështetjen e rrjeteve dhe bizneseve -on-line (portale), - derguar rrjeteve versioni elektronik.	a) Botimi së paku katër herë në vit b) Dhënia e më shumë informative dhe tregime të suksesit; informata të freskuara për legjislacionin për sa i përket zhvillimit të bizneseve, sistemi tatimor c) promovimi i bizneseve ekzistuese të suksesshëm në Kosovë nga Diaspora; d) promovimi i bizneseve të reja të suksesshëm; e) promovimi i profesionistëve të suksesshëm në diaspora	MeD	MTI, MF, MZHE, ASK, BQK, OJQ/rrjetet në Diasporë	2014 - 2016	Buxheti i Kosovës, Anëtarësia në rrjete	€ 2,000.00	Rrjetet te printojnë revistën dhe ta shpërndajnë te anëtarët e rrjetit. Ky botim do të ndikojë pozitivisht në nxitjen e bizneseve të diasporës që të krijojnë rrjetet e tyre.

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>4.1.3. Mbështetje në krijimin e Rrjetit global të bizneseve të diasporës</p>	<p>a) krijimi i një rrjeti global me pjesëmarrës të bizneseve nga e gjithë diaspora (Kuvendi i përgjithshëm mund të shërbejë të ketë edhe këtë rrjet për biznese).</p>	<p>MeD</p>	<p>OJQ/Rrjetet në Diasporë dhe Kosovë, Asociacionet e Bizneseve</p>	<p>K1 2015</p>	<p>Buxheti i Kosovës dhe donacionet</p>	<p>€ 25,000.00</p>	<p>Ko-ordinimi me veprimin 4.2.1 (databaze për bizneset), pasi kontribuon në tërheqjen e bizneseve në rrjetet ekzistuese dhe të reja)</p>
<p>Masa/Nënobjektivi 4.2: Promovimi i investimeve të huaja të drejtpërdrejta nga diaspora në Kosovë</p>							
<p>4.2.1 Organizimi dhe pjesëmarrja në Panairt e bizneseve të Diasporës në Kosovë</p>	<p>a) Të paktën 1 panair në vit i organizuar në Kosovë; b) të paktën 1 panair ose pjesëmarrja në panairt të ndryshme për të promovuar produktet Kosovare në Diasporë</p>	<p>MeD</p>	<p>MTI, MZHE, ministritë e tjera dhe organizata të tjera.</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti i Kosovës</p>	<p>30,000.00</p>	
<p>4.2.2 Organizimi i Konferencave për promovimin e investimeve të diasporës në Kosovë.</p>	<p>a) Së paku 2 konferenca në vit.</p>	<p>MTI dhe MZHE</p>	<p>MeD, Odat Ekonomike dhe rrjetet përkatëse</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti i Kosovës dhe donatorët</p>	<p>60,000.00</p>	

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>4.2.3 Organizimi dhe pjesëmarrja në Forume (takime me disa qëllime: shkëmbim informacione B2B, rrjetëzim dhe promovim biznesesh).</p>	<p>a) Së paku një forum në Kosovë; b) pjesëmarrje e Kosovës dhe Diasporës në të paktën 1 forum ndërkombëtar të bizneseve.</p>	<p>MTI, MZHE</p>	<p>MeD, Odat Ekonomike dhe rrjetet përkatëse</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti I Kosovës dhe donatorët</p>	<p>30,000.00</p>	
<p>4.2.4 Ndërtimi i kapaciteteve të Qendrave Kulturore në diasporë për të lidhur sipërmarrësit e diasporës me mundësitë e biznesit në Kosovë.</p>	<p>a) një zyrtar i kualifikuar i punësuar dhe i përgatitur për secilën QKKDM nga Diaspora</p>	<p>MeD</p>	<p>MTI, Ambasadat dhe rrjetet në Diasporë</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>Buxheti I Kosovës dhe donatorët</p>	<p>10,000.00</p>	
<p>4.2.5 Dhënia e çmimit/mirënjohjes për biznesin më të suksesshëm të diasporës që ka investuar në Kosovë.</p>	<p>a) rritja e numrit të aplikuesve/nominuesëve për këtë çmim/mirënjohje (sipas rregullores në fuqi).</p>	<p>MeD</p>		<p>Çdo vit</p>		<p>0.00</p>	

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>4.2.6 Dhënia dhe gjetja e informacionit për nevojat e bizneseve të diasporës në komuna.</p>	<p>a) Web faqet e komunës të kenë një seksion të dedikuar për Diasporën;</p> <p>b) MeD të ketë një link në faqen për secilën Komunë</p> <p>c) Faqja e MeD të reflektojë rregullisht mundësitë e reja për investim nga secila komunë (highlight).</p>	<p>Komunat</p>	<p>MeD dhe MAPL</p>	<p>K2 2014</p>	<p>0.00</p>		
<p>Masa/Nënobjekti Strategjik 4.3: Lehtësimi i investimeve të diasporës në Kosovë</p>							
<p>4.3.1 Thjeshtësimi i procedurave për heqjen e taksës doganore për lëndën e parë për bizneset e diasporës në Kosovë.</p>	<p>a) caktimi i një zyrtari përgjegjës për të mbledhur kërkesa nga bizneset e diasporës, dhe të ndjek procesin deri në përmbyllje.</p>	<p>MeD</p>	<p>MF</p>	<p>K1 2014</p>	<p>0.00</p>	<p>zyrtarë të punësuar në MeD</p>	
<p>4.3.2 Ndryshimi i ligjeve për heqjen e taksave për pajisjet të operimit të biznesit të ri.</p>	<p>a) Ndryshimi i ligjit për TVSH-në</p>	<p>MF</p>	<p>MeD</p>	<p>K3 2014</p>	<p>0.00</p>		

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

<p>4.3.3 Përfshirja e bizneseve nga diaspora në zonat ekonomike/industriale, parqeve te biznesit, parqeve teknologjike dhe inkubatorët e biznesit.</p>	<p>a) rritja e numrit të kompanive të diasporës të pranishme në këto zona ekonomike (p.sh motivim me qera të ulur ose të hequr, parkingu falas)</p> <p>b) Lehtësira në lidhje me furnizimin me energji elektrike;</p> <p>c) informacioni për zonat industriale, i disponueshëm në faqen e internetit te komunës.</p>	<p>Komunat, MTI, MZHE</p>	<p>Donacionet</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>0.00</p>	
<p>4.3.4 inkurajimi i diasporës për pjesëmarrje aktive në projektet e partneritetit publiko-privat</p>	<p>a) paraqitja e mundësive të PPP në komuna, ne webfaqe te dedikuar për Diasporën;</p> <p>b) rritja e numrit të pjesëmarrësve të diasporës në PPP.</p>	<p>MF</p>	<p>Komunat, MZHE, MTI dhe MeD</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>0.00</p>	<p>Komunat vetëm kanë faqet e tyre, vetëm të shtohen këto mundësi tek seksioni për Diasporë</p>
<p>4.3.5 Negocimi i marrëveshjeve bilaterale me vendet kyçe të destinacionit për të shmangur taksën e dyfishtë, nxitjen e investimeve dhe garancitë për mbrojtjen e investimeve.</p>	<p>a) të paktën një nismë për marrëveshje në vit me shtetet ku ka Diasporë.</p>	<p>MTI</p>	<p>ministritë e linjës (MPJ dhe MF)</p>	<p>2014 - 2016</p>	<p>0.00</p>	<p>Buxheti i Kosovës</p>

Matrica e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018

4.3.6 Promovimi i produkteve të veçanta bankare për pjesëtarët e diasporës.	a) krijimi i të paktën dy produkteve shtesë bankare për Diasporën	Bankat komerciale	MeD, BQK dhe mediat në Kosovë dhe Diasporë	K4 2016		0.00	
Masa/Nënobjektivi Strategjik 4.4: Nxitja dhe promovimi i kthimit të potencialit intelektual							
4.4.1 Identifikimi dhe angazhimi i profesionistëve të profileve të ndryshme që të angazhohen në programe të ndryshme profesionale në Kosovë.	a. Janë identifikuar institucionet që kanë nevojë për angazhimin e profesionistëve të profileve të ndryshme nga diaspora. b. Numri i profesionistëve të angazhuar; c. Numri i programeve të zhvilluara.	MeD	Të gjitha institucionet publike	2014 - 2016	Buxheti i Kosovës dhe donacionet	50,000.00	Ky aktivitet do të bëhet pas publikimit të regjistrimit të diasporës nga ku do të përcaktohet profili shkencëtarëve dhe studiuesve nga diasporës .